



# Pjesëmarrja e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve

**Pasqyrë e Qeverisë 2012**

Marija Sazdevski  
Simona Ognenovska



МАКЕДОНСКИ  
ЦЕНТАР ЗА  
МЕЃУНАРОДНА  
СОРАБОТКА

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

# Pjesëmarrja e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve

**Pasqyrë e Qeverisë 2012**

Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian

Marija Szdevski  
Simona Ognenovska



МАКЕДОНСКИ  
ЦЕНТАР ЗА  
МЕЃУНАРОДНА  
СОРАБОТКА



## **PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË PROCESET E PËRGATITJES SË LIGJEVE**

**Botues:**

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS)

**Për botuesin:**

Aleksandar Krzhhalovski, drejtor i parë ekzekutiv  
Dimëe Mitreski, drejtor ekzekutiv

**Redaktor:**

Emina Nuredinoska, MCMS

**Autorë:**

Marja Sazdevski, MCMS  
Simona Oggenovska, MCMS

**Tirazhi:**

100 kopje

**Dizajn:**

Llazar Tomovski - Arcuss design

**Botoi:**

Arcuss design

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

340.13:342.571(497.7)"2012"  
340.13:061.2(497.7)"2012"

SAZDEVSKI, Marija

Pjesëmarrja e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve :  
Pasqyrë e Qeverisë 2012 / Marija Sazdevski, Simona Oggenovska. -  
Shkup : Qendra Maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar (MCMS), 2013.  
- 48 str. : tabeli ; 30 cm

Фусноти кон текстот. - Содржи и: Shtojca 1-3

ISBN 978-608-4681-11-3

1. Oggenovska, Simona [автор]

а) Закони - Подготовка - Граѓанска партиципација - Македонија -  
2012

COBISS.MK-ID 93579274

Mendimet e shprehura këtu u takojnë autorëve dhe nuk i shprehin qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura. Riprodhimi, kopjimi, transmetimi apo përkthimi i cilës do pjesë të këtij publikimi mund të kryhet vetëm nën këto kushte: me leje paraprake nga botuesi, për citim në analizë libri dhe nën kushtet e dhëna në vijim.

E drejta autoriale e këtij publikimi është e mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilën do mënyrë pa pagesë për qëllime edukative. Për kopje në kushte të tjera, për përdorim në publikime të tjera apo për përkthim dhe adaptim duhet paraprakisht të merret leje nga botuesi.

Në formë elektronike publikimi gjendet në këtë faqe interneti [www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk)

*"Ky publikim është përgatitur me ndihmë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe në asnjë mënyrë nuk i reflekton qëndrimet e Bashkimit Evropian."*

# PËRMBAJTJA

<b>LISTA E SHKURTESAVE</b> .....	4
<b>PARATHËNIE</b> .....	5
<b>HYRJE</b> .....	7
<b>1. PROJEKTI: PASQYRA E QEVERISË</b> .....	8
<b>2. REZULTATET NGA HULUMTIMI MBI TRANSPARENCËN E ORGANEVE SHTETËRORE</b> .....	9
2.1. Metodologjia dhe qasja .....	9
2.1.1. Instrumentet e hulumtimit.....	9
2.1.2. Ekzemplari.....	10
2.1.3. Përpunimi dhe pasqyrimi i rezultateve .....	10
2.1.4. Kufizime metodologjike.....	11
2.1.5. Shpjegime terminologjike .....	11
2.2. Rezultatet sipas indikatorëve për transparencën e institucioneve .....	12
2.2.1. Fusha A: Mjedisi komunikues.....	12
2.2.2. Fusha B: Mjedisi mbështetës për pjesëmarrjen e shoqërisë civile .....	14
2.2.3. Fusha C: Përgatitja e akteve/ projekt-ligjeve .....	19
2.2.4. Reagimi i sektorit civil .....	25
2.3. Rezultatet sipas ministrive .....	26
2.3.1. Fushat A dhe B: Komunikimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përfshirjen e shoqërisë civile në punën e vet .....	26
2.3.2. Fusha C: Përgatitja e akteve.....	28
2.3.3. Rezultatet e përgjithshme .....	30
2.4. Përfundime dhe rekomandime .....	31
2.4.1. Përfundime .....	31
2.4.2. Rekomandime .....	32
<b>3. REZULTATE NGA PËRCJELLJA NË INTERNET</b> .....	34
3.1. Metodologjia dhe qasja .....	34
3.1.1. Ekzemplar .....	34
3.1.2. Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve .....	34
3.1.3. Kufizime metodologjike .....	34
3.2. Monitorimi i ENER .....	35
3.2.1. Ruajtja e afatit kohor për konsultime sipas rregullores së Qeverisë dhe sipas Udhëzimit .....	35
3.2.2. Praktika të komentimit në ENER .....	37
3.2.3. Praktikrat për azhurnim të projekt-dispozitave të hapura në ENER .....	37
3.3. Monitorimi i ueb-faqeve të ministrive .....	38
3.4. Përfundime dhe rekomandime .....	39
3.4.1. Përfundime .....	39
3.4.2. Rekomandime .....	40
<b>Shtojca 1: Mbështetja komunikuese</b> .....	41
<b>Shtojca 2. Pyetësor për përfshirjen e publikut në procesin e përgatitjes së propozim-ligjeve</b> .....	43
<b>Shtojca 3. Lisat e projekt-ligjeve të përfshira në analizë sipas ministrive</b> .....	47



## LISTA E SHKURTESAVE

ARS – Agjencia për të Rinjtë dhe Sport

BCSDN – Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile

DKSK – Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit

EIDHR – Instrumenti për të Drejtat e Njeriut dhe Demokracisë

ENER – Regjistri i Vetëm Elektronik Nacional i Dispozitave

BE – Bashkimi Evropian

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

ME – Ministria e Ekonomisë

MMJPH – Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor

MSh – Ministria e Shëndetësisë

MBPU – Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujërave

MShIA – Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës

MK – Ministria e Kulturës

MVL – Ministria e Vetëqeverisjes Lokale

MPJ – Ministria e Punëve të Jashtme

MM – Ministria e Mbrojtjes

MASh – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

MD – Ministria e Drejtësisë

MTL – Ministria e Transportit dhe Lidhjeve

MPPS – Ministria e Punës dhe Politikës Sociale

MF – Ministria e Financave

MCMS – Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

VNN - Vlerësim i ndikimit të normativës

SÇE – Sekretariat për Çështje Evropiane

SZMK – Sekretariat për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë

QIBZhOQ – Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare

## PARATHËNIE

Publikimi “Pasqyra e Qeverisë 2012: pjesëmarrja e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve” është vegël e cila duhet t’u shërbejë organizatave qytetare, nëpunësve shtetëror dhe në përgjithësi opinionit, që të informohen për transparencën e institucioneve dhe t’i rritë njohuritë për proceset e përgatitjes së ligjeve.

Synimi i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) si botues i këtij publikimi është të kontribuojë drejt avokimit dhe pjesëmarrjes së shoqërisë civile në përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike, përmes vendosjes së modelit për përcjellje të transparencës së proceseve të përgatitjes së ligjeve dhe informimin për zbatimin e mekanizmave ekzistuese me të cilat është paraparë përfshirja e publikut.

Analiza përbëhet prej dy pjesëve. Pjesa e parë i përmban rezultatet e fituara përmes pyetësorëve të dërguar deri te institucionet shtetërore, përmes të cilave është vlerësuar transparenca e institucioneve shtetërore në komunikimin me opinionin dhe transparenca e proceseve të përgatitjes së 26 akteve të 12 ministrive. Në pjesën e dytë janë prezantuar rezultatet nga përcjellja e standardeve minimale për pjesëmarrje të opinionit në përgatitjen e ligjeve, gjegjësisht respektimi i afatit kohor për konsultime për propozim-ligjet e shpallura të regjistrit të vetëm nacional të rregulloreve (ENER). Gjithashtu është përgatitur pasqyrë për atë se si ministrinë i shfrytëzojnë ueb faqet e veta për publikimin e propozim-ligjeve dhe informimin e opinionit për mundësinë që të përfshihet në përgatitjen e propozim-ligjeve.

Analiza është përgatitur nga Marija Sazdovska dhe Simona Oggenovska, të dyja nga MCMS. MCMS e përgatiti këtë publikim si pjesë të projektit “Pasqyra e Qeverisë”, i financuar nga Instrumenti Evropian për të drejta të njeriut dhe demokraci (EIDHR) nga Bashkimi Evropian.

Emina Nuredinoska

Udhëheqëse e Departamentit  
për shoqëri civile dhe demokraci



## HYRJE

Rëndësia e pjesëmarrjes publike në krijimin e politikave po rritet gjithnjë e më shumë në përmasa globale dhe janë krijuar një numër i madh rekomandimesh për pjesëmarrjen e opinionit dhe organizatave qytetare në këto procese. Përveç asaj se bëhet fjalë për rekomandime të cilat nuk janë të obligueshme, megjithatë ato ofrojnë standarde, parime dhe praktika më të mira të cilat duhet të merren parasysh gjatë dizajnit të iniciativave në nivel lokal.

Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë dokumente të cilat e japin bazën për pjesëmarrjen e publikut në proceset e miratimit të ligjeve. Ato janë Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, pastaj Ligji për referendum dhe format e tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë, Ligji i punës së Qeverisë, Ligji i organizimit dhe punës në organet e administratës shtetërore etj. Gjithashtu një sërë aktesh nënligjore e rregullojnë këtë çështje: Rregullorja për punën e Qeverisë, Strategjia e bashkëpunimit të Qeverisë me sektorin civil, Kodeksi i praktikave të mira për pjesëmarrje të sektorit civil në procesin e krijimit të politikave, Metodologjia për vlerësim të ndikimit të rregullores dhe Udhëzimi për mënyrën e veprimit në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën e përgatitjeve të ligjeve.

Analiza për pjesëmarrjen e organizatave qytetare në procesin e krijimit të politikave do ta rritë informimin dhe njohuritë e qytetarëve, organizatave qytetare dhe organeve të administratës shtetërore dhe në të ardhmen do të mund të përdoret si model për përcaktimin e rregullave dhe standardeve për pjesëmarrje në vendimmarrje.

Analiza është rezultat i përcjelljes së shkallës së përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e përgatitjes së ligjeve në suazat e projektit "Pasqyra e qeverisë". Duke e ndjekur metodologjinë e përcaktuar paraprakisht, MCMS-ja e ka ndjekur përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e miratimit të ligjeve, për herë të parë, në periudhën nga 01.03.2012 deri më 31.12.2012.





# 1. PROJEKTI: PASQYRA E QEVERISË

“Pasqyra e Qeverisë” është emri i përbashkët i disa projekteve për përcjelljen e transparencës në institucionet shtetërore, të cilat janë zbatuar në Slloveni në periudhën nga viti 2002 deri në vitin 2010. Projekti “Pasqyra e Qeverisë” për herë të parë zbatohet në Republikën e Maqedonisë dhe përfshiu një sërë aktivitete.

Projekti **Pasqyra e Qeverisë** ka për **qëllim** të kontribuojë në përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike. Me zbatimin e aktiviteteve, projekti ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit të organizatave qytetare me organet e administratës shtetërore në proceset e krijimit të politikave dhe përgatitjen e ligjeve. **Grupi qëllimor** janë organizatat qytetare dhe organet e administratës shtetërore (kryesisht ministritë resurse, por edhe organet tjera të cilat bashkëpunojnë dukshëm me sektorin civil).

**Rezultatet** e realizuara me projektin janë:

1. Sistem i vendosur dhe që zbatohet vazhdimisht për përcjelljen e përfshirjes së shoqërisë civile në proceset e përgatitjes së ligjeve;
2. Kapacitetet të përmirësuara të organizatave qytetare për përfshirje në proceset e përgatitjes së ligjeve.

Në suazat e projektit është zbatuar metodologjia për vlerësimin e transparencës së institucioneve, e zhvilluar nga Qendra për Informim, Bashkëpunim dhe Zhvillim të Organizatave Qytetare (QIBZhOQ). Janë zhvilluar edhe disa e-pajisje për përcjelljen e pjesëmarrjes së opinionit në krijimin e politikave dhe përgatitjen e ligjeve, një prej të cilave është edhe ueb-faqja [www.ogledalonavlada.mk](http://www.ogledalonavlada.mk). Si rezultat i aktiviteteve të përshkruara më parë, doli kjo analizë për vlerësimin e pjesëmarrjes së opinionit në krijimin e politikave dhe procedurave për përgatitjen e ligjeve.

Me qëllim që të përforcohen kapacitetet e organizatave qytetare për pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset e krijimit të politikave dhe përgatitjen e ligjeve, ishin organizuar dy trajnime themelore dhe dy trajnime të avancuara, ku mbi 60 përfaqësues të organizatave qytetare kishin mundësi të merrnin njohuri dhe ushtrime praktike për inkuadrim efikas në përgatitjen e ligjeve. Në suazat e tri punëtorive u përcaktuan prioritetet e bashkëpunimit dhe u zhvilluan drejtimet strategjike për bashkëpunim me organet e administratës shtetërore për çështje të rëndësishme për sektorin civil. Projekti u mundësoi edhe organizatave qytetare vendase t’i dëgjojnë dhe t’i shkëmbejnë praktikatat e mira lidhur me përcjelljen e politikave qeveritare në rajon, në suazat e punëtorisë rajonale të mbajtur më 5 korrik 2012.

## 2. REZULTATET NGA HULUMTIMI MBI TRANSPARENCËN E ORGANEVE SHTETËRORE

### 2.1. Metodologjia dhe qasja

Metodologjia e aplikuar në këtë analizë bazohet në përvojat pozitive në përcjelljen e organeve të administratës shtetërore në Slloveni dhe mbi përvojën ekzistuese të MCMS-së në përgatitjen e përcjelljes dhe vlerësimit të procesit të miratimit të ligjeve në Republikën e Maqedonisë.

Analiza e transparencës së institucioneve ndaj shoqërisë civile gjatë krijimit të politikave publike dhe legjislacionit është model i cili përdoret me sukses në Slloveni prej vitit 2006. Metodologjia është zhvilluar nga CNVOS nga Sllovenia, kurse në koordinim me ekipin e projektit të MCMS-së dhe fokus grupet e ndara të organizatave qytetare dhe organeve të administratës shtetërore është përshtatur në kontekstin lokal. Kjo metodologji mbulon tri fusha: mjedisin komunikues (praktikat komunikuese) të organeve të pushtetit shtetëror (në përgjithësi, mekanizma për përfshirje të shoqërisë civile), mjedisin mbështetës për përfshirjen e shoqërisë civile dhe procedurën për përgatitjen e ligjeve.

Përcjellja e transparencës së proceseve të përgatitjes së projekt-ligjeve në Maqedoni u realizua në periudhën nga 1 marsi – 31 tetor 2012.

#### 2.1.1. Instrumentet e hulumtimit

Përcjellja e transparencës është ndarë në tri pjesë:

- Fusha A: Mjedisin komunikues i krijuar nga organet e administratës shtetërore për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në aktivitetet e organit (mekanizmi i përgjithshëm për pjesëmarrjen e publikut);
- Fusha B: Mjedisin mbështetës për pjesëmarrje të shoqërisë civile, i krijuar nga organet e administratës shtetërore si propozues të akteve, përkatësisht projekt-ligjeve (vendosja institucionale e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në aktivitetet e organeve të administratës shtetërore, mjedisin mbështetës financiar-material i siguruar nga ana e organeve për pjesëmarrje të shoqërisë civile në përgatitjen e akteve, përcjellja dhe vlerësimi i zbatimit të akteve);
- Fusha C: Përgatitja e akteve (shpallja e procedurës për përgatitjen e akteve, qasja te baza profesionale për përgatitjen e akteve, informacione kthyesë për propozuesin e akteve për propozime dhe vërejtje nga shoqëria civile, konsistencë e përmbajtjes midis propozuesit dhe shoqërisë civile etj.).

Instrumenti kryesor për vlerësimin e përfshirjes së shoqërisë civile në krijimin e politikave dhe përgatitjen e ligjeve janë dy pyetësorë. Me pyetësorin e parë janë analizuar fushat A dhe B, kurse me pyetësorin e dytë fusha C. Pyetësorët gjenden në Shtojcën 1 dhe 2.

Çdo fushë ka indikatorët e vet të cilët janë formuluar si deklaratatë të cilat i paraqesin standardet për përfshirjen e mirë të opinionit. Në pyetësorin e parë janë përcaktuar 35 indikatorë (15+20), kurse në me pyetësorin e dytë vlerësohen 40 indikatorë për transparencën në procesin e përgatitjes së akteve konkrete, përkatësisht projekt-ligjeve.



## 2.1.2 Ekzemplari

Pyetësi i parë është dërguar deri në 15 ministri dhe 8 institucione të tjera shtetërore. Përgjigje është marrë nga 11 ministri: Ministria e Mbrojtjes (MM); Ministria e Punëve të Brendshme (MPB); Ministria e Drejtësisë (MD); Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS); Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH); Ministria e Ekonomisë (ME); Ministria e Transportit dhe Lidhjeve (MTL); Ministria e Kulturës (MK); Ministria e Vetëqeverisjes Lokale (MVP); Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit të Hapësirës (MMJPH); Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MShIA); dhe 6 institucione – Sekretariati për Çështje Evropiane (SÇE); Agjencia për të Rinjtë dhe Sport (ARS); Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë (SZMK); Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD), Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare (KMBF) dhe Komisioni Shtetëror për Pengim të Korrupsionit (KShPK).

Pyetësi i dytë u është dërguar 13<sup>1</sup> ministrive për 33 projekt-ligje të përzgjedhura apo për propozim për ndryshime dhe plotësime të ligjeve për të cilat është përcjellë aplikimi i rregullave për pjesëmarrje transparente të opinionit. Në ekzemplar janë përzgjedhur dispozitat për të cilat janë bërë konsultime deri më 30 shtator 2012. Përgjigje është marrë nga 12 ministri dhe për 26 projekt-ligje. Në Shtojcën 3 është dhënë lista e të gjitha projekt-ligjeve për të cilat është dërguar pyetësi për t'u plotësuar me vërejtje për cilin ligj është marrë përgjigje.

## 2.1.3. Përpunimi dhe pasqyrimi i rezultateve

Rezultatet e pasqyruara bazohen në përpunimin e informatave të marra nga pyetësit, kurse janë përdorur metoda statistikore përshkruese.

Përgjigjet e ministrive për çdo indikator janë vlerësuar me pikë. Notat për indikatorët janë marrë si përqindje prej pikëve të realizuara në raport me numrin maksimal të pikëve për atë indikator. Pastaj, në bazë të përqindjes, vlerësimi i indikatorëve të veçantë është nga 1 deri në 5:

<b>Nota 1 (nota më e ulët)</b>	<b>(i vlerësuar me 20% ose më pak)</b>
<b>Nota 2</b>	(vlerësuar nga 21% deri në 40%)
<b>Nota 3</b>	(vlerësuar nga 41% deri në 60%)
<b>Nota 4</b>	(vlerësuar nga 61% deri në 80%)
<b>Nota 5 (nota më e lartë)</b>	(vlerësuar nga 81% deri në 100%)

Për fushat A dhe B rezultatet janë dhënë veçmas, nga njëra anë për ministrinë, kurse nga ana tjetër për institucionet shtetërore. Arsyeja për prezantimin e tillë të veçantë qëndron në faktin se një pjesë

<sup>1</sup> Përveç MVL-së dhe MM-së të cilat në periudhën e përcjelljes nuk kanë propozuar ligj apo ndryshim dhe plotësim ligjesh.

e indikatorëve janë relevantë vetëm për ministrinë, por jo edhe për institucionet e tjera shtetërore. Për shembull, indikator i me të cilin vlerësohet se a ka koordinator i cili kryen vlerësim të ndikimit të rregullativës është relevant vetëm për ministrinë, kurse jo edhe për shembull për Komisionin Shtetëror për Pengim të Korrupsionit apo për Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi etj.

Rezultatet e analizuar janë dhënë në dy mënyra. Së pari janë prezantuar notat sipas indikatorëve, përkatësisht për çdo pyetje/indikator është dhënë nota e përgjithshme për të gjitha institucionet e analizuar. Shtesë, në këtë dokument janë dhënë edhe rezultatet e veçanta për çdo ministri apo institucion. Kjo përcjellje e gjendjeve nga dy perspektiva të ndryshme, në përgjithësi për situatën e dhënë dhe konkrete për raportin e çdo institucioni më vete, mundëson pasqyrim më të qartë dhe mundësi më të madhe për identifikim të mangësive dhe mundësive për një përmirësim të ardhshëm.

#### 2.1.4. Kufizime metodologjike

Qasja për analizën e transparencës së institucioneve përmban edhe kufizime të caktuara. Domethënë, rezultatet bazohen në përgjigjet e pyetësorëve nga organet e administratës shtetërore, kurse gjatë kësaj nuk është parashikuar kontroll shtesë i pohimeve, përkatësisht nuk është bërë analizë me organizatat qytetare për projekt-ligje konkrete. Për shkak të krahasimit të informacioneve me ato të Sllovenisë, në këtë hulumtim të parë është zbatuar tërësisht metodologjia e njëjtë. Prandaj, edhe përkrah vendosjes së qartë të indikatorëve ishte e pamundur të anashkalohej një subjektivizëm i caktuar në përgjigjet apo një kuptim jo i njëtrajtshëm i pyetjeve. Gjithashtu, si kufizim mund të konsiderohet dhe pamundësia të arrihen deri te të dhënat e dëshiruara, në ndonjë mënyrë tjetër, përveç se duke i dhënë përgjigje pyetësorit. Kjo e nxiti nevojën për përpjekje plotësuese që të merren përgjigjet në kohë. Në analizë nuk janë përfshirë aktet e propozuara nga Ministria e Financave (MF) sepse deri më 8 janar 2013 nuk arritën përgjigjet e pyetësorëve të dorëzuar. Një kufizim shtesë është edhe fakti se përgjigjet e pyetjeve në parim janë të mbyllura dhe nuk kërkohen informacione apo shembuj shtesë. Për shembull, për një çështje të caktuar në praktikë ministria vetëm njëherë mund të ketë zbatuar një masë të caktuar dhe kjo të jetë shënuar si praktik e përhershme. Megjithatë duke pasur parasysh se nëpërmjet kësaj analize dëshirohet përveç vlerësimit për transparencë, të ndikohet edhe në forcimin e vetëdijes për përmirësim të praktikës dhe standardeve për përfshirje, vendosëm që edhe në lidhje me këtë pyetje ta pranojmë tërësisht metodologjinë e ofruar pa kontrolle shtesë së informacioneve të dhëna.

#### 2.1.5. Shpjegime terminologjike

Në këtë analizë përdoren termet sektori civil, shoqëria civile, organizata qytetare dhe ka të bëjë me kuptimin e gjerë të shoqërisë civile, përkatësisht shoqatave dhe fondacioneve, merren parasysh edhe aktorë të tjerë. Si shtesë për çështje të caktuara merren parasysh të gjitha palët e prekura të cilat kanë interes të përfshihen në proceset e përgatitjes së ligjeve. Gjatë përcaktimit të palëve të prekura, është marrë parasysh përkufizimi i përcaktuar në Udhëzimin për mënyrën e veprimit në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën e përgatitjes së ligjeve dhe me këtë udhëzim përfshihen: *bashkësia e biznesit, organizatat joqeveritare, shoqatat dhe fondacionet, personat fizikë dhe juridikë të cilët në çfarëdo mënyrë mund të preken nga implementimi i projekt-ligjit që përgatitet*. Gjithashtu, termet akt, projekt-ligj, propozim për ndryshime dhe plotësime të ligjit dhe shumësi i këtyre termeve kanë të njëjtin kuptim.



## 2.2. Rezultatet sipas indikatorëve për transparencën e institucioneve

### 2.2.1. Fusha A: Mjedisi komunikues

Siç është shpjeguar më sipër, rezultatet janë dhënë veçmas për ministrinë dhe veçmas për institucionet e tjera, për shkak se një pjesë e indikatorëve nuk janë relevantë për të gjitha institucionet.

Të gjitha ministrinë kanë ngarkuar nga një person përgjegjës për dhënien e informacioneve me karakter publik, kurse 73% e tyre kanë publikime (buletine/revista) për punën e vet. Ministrinë i plotësojnë tërësisht obligimet e tyre të cilat dalin nga metodologjia për vlerësim të ndikimit të rregullativës (VNRr), kështu që të gjitha ministrinë kanë ngarkuar koordinators, i cili kryen vlerësim të ndikimit të rregullativës dhe të gjithë publikojnë informacion për fillimin e procedurës për ligjin në ueb faqet relevante si ENER, e-demokratija, ueb-faqe të ministrisë. Informacioni për fillimin e përgatitjes së ligjeve është shpallur në gazetën ditore për 36% të akteve, që nuk është cekur edhe në mënyrë eksplicite si obligim ligjor i ministrive. Si për shembull, MM thotë se dorëzon "Lajmërim" me të cilin informohen të gjitha mediat për fillimin e procedurës për ndryshimet ligjore. Si forma të tjera për informim të publikut institucionet më shpesh i japin evenimentet publike dhe konferencat për shtyp, fushatat në media dhe posta elektronike për palët e prekura.

Në ueb-faqet e veta pothuajse të gjitha ministrinë (91%) shpallin detaje dhe informacione për përfshirjen e opinionit në proceset konkrete (ligje, strategji etj.). Konsultimet me publikun në proceset e përgatitjes së ligjeve shpesh kryhen përmes postës elektronike me informacione për publikun e interesuar (82%) ose nëpërmjet debateve elektronike publike (forume, bllok, ueb-konferenca etj.) për të cilat përgatitet dhe shpallet raport (64%). Numri i ministrive të cilat përdorin e-pyetësorë për marrjen e mendimit prej publikut për punën e përgjithshme të ministrisë është i vogël (18%) ose për procese konkrete (36%). MShIA shpjegon se momentalisht pyetësorët dorëzohen te palët e prekura nëpërmjet e-postës, sepse portali e-demokratija ku janë paraparë përmbajtjet e tilla është në zhvillim e sipër. Niveli i propozimeve të shpallura dhe komenteve të marra nga publiku i interesuar lidhur me punën e ministrisë është 36% dhe në procese konkrete 18%. Vetëm dy ministri, MMJPH dhe MShIA mundësojnë publiku i interesuar të regjistrohet në regjistrin për marrjen e informacioneve.

**3,47**

është nota mesatare për mjedis komunikues e krijuar nga propozuesi i aktit (ministrinë) për pjesëmarrje të shoqërisë civile në aktivitetet e saja.

**TABELA 1. Fusha A: Mjedisi komunikues (Ministri)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=10)	Nota
<b>Ministria:</b>			
1	Ka emëruar person përgjegjës për kontakt për dhënie të informacioneve me karakter publik	100%	5
2	Ka emëruar koordinator i cili kryen vlerësim të ndikimit të rregullativës	100%	5
3	Publikon botime (buletine/revista) për punën e vet	73%	4
4	Shpall gjithmonë informacion për fillimin e përgatitjes së ligjeve në gazetatat ditore	36%	2
5	Shpall informacion për fillimin e procedurës për ligj në ueb-faqet relevante si ENER, e-demokratija, ueb-faqja e ministrisë	100%	5
6	Përdor forma të ndryshme për informim të publikut	91%	5
<b>Ministria në ueb-faqen e vet apo e-buletin:</b>			
7	Publikon detaje dhe informacione për përfshirjen e publikut në proceset konkrete (ligje, strategji etj.)	91%	5
8	Përdor e-pyetësorë për marrjen e mendimit prej publikut	18%	1
9	Publikon propozime dhe komente të marra nga publiku i interesuar lidhur me punën e ministrisë	36%	2
10	Përdor e-pyetësor për marrjen e vendimit nga publiku veçanërisht për procese konkrete	36%	2
11	Publikon përgjigje dhe shpjegime të propozimeve dhe komenteve të dhëna nga publiku i interesuar	64%	4
12	I publikon pyetjet e bëra të shpeshta dhe përgjigjet për përfshirjen e publikut në procese të caktuara konkrete	18%	1
13	Mundëson publiku i interesuar të regjistrohet në regjistrin për marrje të informacioneve	27%	2
14	Dërgon e-postë me informacion te publiku i interesuar	82%	5
15	Organizon e-debate publike (forum, bllok, ueb-konferenca etj.) për të cilat përgatit dhe shpall raporte	64%	4
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>3,47</b>



Institucionet e tjera kanë një notë mesatare pak më të ulët se 3,1 në raport me ministrinë, kjo ka të bëjë më shumë me notat më të ulëta kur bëhet fjalë për përdorimin e ueb-faqeve të tyre si kanal komunikues me publikun. Kështu vetëm ARS e përdor ueb-faqen e vet për organizimin e e-debateve publike. Është pozitive se 67% të institucioneve publikojnë detaje dhe informacione për përfshirjen e publikut në proceset konkrete dhe rregullisht dërgojnë e-postë me informacione për publikun e interesuar.

**TABELA 2. Fusha A: Mjedisi komunikues (institucione të tjera)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=6)	Nota
<b>Institucioni:</b>			
1	Ka emëruar person për kontakt për të dhënë informacione me karakter publik	100%	5
3	Publikon botime (buletine/revista) për punën e vet	50%	3
6	Përdor forma të tjera për informim të publikut	83%	5
<b>Institucioni në ueb-faqen e vet apo e-buletini:</b>			
7	Publikon detaje dhe informacione për përfshirjen e publikut në proceset konkrete (ligje, strategji etj.)	67%	4
8	Përdor e-pyetësorë për marrjen e mendimit prej publikut	50%	3
9	Publikon propozime dhe komente të marra nga publiku i interesuar lidhur me punën e institucionit	33%	2
14	Dërgon e-postë me informacion te publiku i interesuar	67%	4
15	Organizon e-debate publike (forum, bllok, ueb-konferenca etj.) për të cilat përgatit dhe shpall raporte	17%	1
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>3,1</b>

### 2.2.2. Fusha B: Mjedisi mbështetës për pjesëmarrjen e shoqërisë civile

Me rëndësi të veçantë për pjesëmarrjen aktive të sektorit civil në proceset e përgatitjes së ligjeve është ekzistenca e mjedisit mbështetës për përfshirjen e tyre. Në këtë pjesë janë përcaktuar tri tërësi me të cilat vlerësohet mjedisi për përfshirjen e shoqërisë civile:

1. mekanizëm për përfshirjen e publikut në aktivitetet e ministrive dhe institucionet e tjera shtetërore (vendosja institucionale);
2. mjedisi financiar; dhe
3. përfshirje në përcjelljen dhe vlerësimi i zbatimit të akteve.

**2,65**

është nota mesatare për mjedisin mbështetës të pjesëmarrjes së shoqërisë civile.

### 2.2.2.1. Vendosja institucionale e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në aktivitetet e propozuesit të aktit

Me notë mesatare 3,13 për kornizën institucionale për përfshirjen e sektorit civil nga ministritë mund të thuhet se në të ardhmen duhet të ndikohet në përmirësimin e segmenteve të caktuara ku janë vërejtur mangësi. Është pozitive ajo se 91% e ministrive kanë emëruar person për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe gjithashtu po kaq prej tyre i përfshijnë përfaqësuesit e organizatave qytetare në organet konsultuese dhe komisionet e ministrive. Ministritë ndërmarrin masa për aftësim të punësuarve për bashkëpunim dhe përfshirjen e organizatave qytetare, kështu 82% e tyre kanë nëpunës shtetërorë të cilët kanë marrë pjesë në trajnime për përforcimin e kapaciteteve për bashkëpunim. Ajo që mungon është ekzistenca e rregulloreve të shkruara (përkatëse për ministri konkrete) për zgjedhje dhe përfshirje të palëve të prekura në punën, përkatësisht krijimin e politikave në ministri. Vetëm dy ministri, MD dhe MPPS, kanë dokument të veçanta të shkruara (drejtime) për përfshirjen e organizatave qytetare, kurse MM dhe MMJPH kanë procedurë të paraparë për përzgjedhje të organizatave qytetare kur numri për pjesëmarrje është i kufizuar. Është i vogël numri i ministrive (27%) të cilat kanë regjistra në të cilët mund të regjistrohen hapur organizatat qytetare që të marrin rregullisht informacione apo përsëri ministritë t'i bëjnë thirrje organizatave qytetare të interesuara të paraqiten, përkatësisht të regjistrohen që të marrin informacione: MShIA, MMJPH dhe MPPS. Shembull i mirë është MMJPH e cila në ueb-faqen e vet ka vendosur formular për azhurnim të dhënave për organizatat qytetare në Republikën e Maqedonisë të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor.

**TABELA 3. Vendosja institucionale (Ministri)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=10)	Nota
<b>Ministria:</b>			
16	Ka emëruar person për bashkëpunim me organizatat qytetare	91%	5
17	Ka regjistër ku mund të regjistrohen hapur organizatat qytetare (që të marrin rregullisht informacione)	27%	2
18	U bën thirrje organizatave qytetare të interesuara të paraqiten/regjistrohen për të marrë informacione	27%	2
19	Ka dokument të veçantë të shkruar (drejtime) për përfshirje të organizatave qytetare	18%	1
20	Përfshin përfaqësues të organizatave qytetare në organet konsultuese dhe komisionet e ministrisë edhe kur kjo nuk është e obliguar me shkrim	91%	5
21	Përfshin përfaqësues të shoqërisë civile në delegacionet e veta në eventet ndërkombëtare	45%	3
22	Ka procedurë të përcaktuar paraprakisht për përzgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri i pjesëmarrjes është i kufizuar	27%	2
23	Ka nëpunës shtetërorë të cilët janë edukuar (kanë marrë pjesë në trajnime) për bashkëpunim dhe përfshirjen e organizatave qytetare	82%	5
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>3,13</b>





Tek institucionet e tjera situata është e ngjashme. kështu që vetëm tek ARS ka regjistër ku mund të regjistrohen organizatat qytetare (për të marrë informacione rregullisht), kurse SÇE ka procedurë të përcaktuar paraprake për përzgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri është i kufizuar. Situatë më e mirë sesa tek ministritë është fakti se tri institucionet e tjera kanë dokument të veçantë të shkruar (drejtime) për përfshirje të organizatave qytetare: SÇE, ARS dhe KShPK. Kështu për shembull, KShPK-ja ka nënshkruar memorandum për bashkëpunim me organizatat qytetare mbi të cilin bazohet bashkëpunimi me sektorin për çështje për anti-korrupsion.

**TABELA 4. Vendosja institucionale (Institucione të tjera)**

Nr.	Titulli i indikatorit	rezultate (n=6)	Nota
<b>Ministria:</b>			
16	Ka emëruar person për bashkëpunim me organizatat qytetare	83%	5
17	Ka regjistër ku mund të regjistrohen hapur organizatat qytetare (që të marrin rregullisht informacione)	17%	1
18	U bën thirrje organizatave qytetare të interesuara të paraqiten/ regjistrohen për të marrë informacione	33%	2
19	Ka dokument të veçantë të shkruar (drejtime) për përfshirje të organizatave qytetare	50%	3
20	Përfshin përfaqësues së organizatave qytetare në organet konsultuese dhe komisionet e ministrisë edhe kur kjo nuk është e obliguar me shkrim	50%	3
21	Përfshin përfaqësues të shoqërisë civile në delegacionet e veta në eventet ndërkombëtare	17%	1
22	Ka procedurë të përcaktuar paraprakisht për përzgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri i pjesëmarrjes është i kufizuar	17%	1
23	Ka nëpunës shtetërorë të cilët janë edukuar (kanë marrë pjesë në trajnime) për bashkëpunim dhe përfshirje të organizatave qytetare	67%	4
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2,5</b>

#### **2.2.2.2. Mjedis i financiar për mbështetjen e sektorit civil**

Notën mesatare prej 2,17 ministritë e kanë marrë për pyetjen e mjedisit financiar për mbështetjen e sektorit civil. Gjysma e tyre kanë mjete për financim të programeve dhe projekteve të organizatave qytetare. Asnjë ministri nuk ka paraparë mjete për mbështetje eksperte për pjesëmarrje (si për shembull, konsultues juridikë dhe mbështetje informuese) dhe përfaqësim të organizatave qytetare në proceset e përgatitjes së ligjeve. MK dhe MM janë të vetmet të cilat organizatave qytetare u sigurojnë zyra pa pagesë ose me subvencione.

**TABELA 5. Mjedisi financiar (ministri)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=10)	Nota
<b>Ministria:</b>			
24	Financon programe (mbështetje institucionale) të organizatave qytetare	45%	3
25	Financon projekte (aktivitete projektsh) të organizatave qytetare	45%	3
26	Ka mjete për mbulim të shpenzimeve për pjesëmarrësit e sektorit civil në organet dhe grupet e punës dhe këshillëdhënëse	27%	2
27	Ka paraparë mjete për mbështetje eksperte në pjesëmarrje (si për shembull, konsultime dhe mbështetje informuese) dhe përfaqësim të organizatave qytetare	0%	1
28	Organizatave qytetare u siguron zyra pa pagesë ose me subvencione	18%	1
29	Mundëson forma të tjera të mbështetjes (si dhënie pajisje, trajnime etj.)	45%	3
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2,17</b>

Nga institucionet e tjera vetëm ARS-ja organizatave qytetare u siguron zyra pa pagesë ose me subvencione <sup>2</sup>.

**TABELA 6. Mjedisi financiar (institucione të tjera)**

Institucioni:		Rezultati (n=6)	Nota
28	Organizatave qytetare u siguron zyra pa pagesë ose me subvencione	17%	1
29	Mundëson forma të tjera të mbështetjes (si dhënie pajisje, trajnime etj.)	50%	3

### 2.2.2.3. Ndjekja dhe vlerësimi i zbatimit të akteve

Edhe pse ministritë në një përqindje të madhe (91%) e ndjekin dhe e vlerësojnë zbatimin e akteve në fushën e vet, një numër i vogël prej tyre (18%) i shpallin raportet e ndjekjes dhe vlerësimit të akteve si në formë elektronike ashtu edhe në formë të botuar. MASH i shpall raportet edhe në ueb-faqe dhe në formë publikimi, kurse MMJPH këtë gjë e bën në format elektronik, MVL në formë të botuar. Gjysma e tyre përfshijnë përfaqësues të organizatave qytetare në këto aktivitetet. Në periudhën e analizuar vetëm MD-ja ka botuar raport me informata për përfshirjen e publikut dhe ndikimi i komenteve për përcjelljen e zbatimit të akteve në kompetencat e tyre.

2 Agjencia për të Rinjtë dhe Sport gjithashtu jep edhe mbështetje financiare për shoqatat dhe fondacionet, por meqenëse Agjencia nuk është krahasuar me ministritë, por me institucionet e tjera për të cilat pyetja e mbështetjes financiare nuk është relevante, vendosëm që edhe për Agjencinë të mos bëhet kjo pyetje. Njëkohësisht kjo nuk ndikon negativisht, përkatësisht nuk e zvogëlon mesataren e notës së përgjithshme për Agjencinë.



**TABELA 7. Ndjekje dhe vlerësim (Ministri)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=10)	Nota
<b>Ministria:</b>			
30	E përcjell dhe e vlerëson zbatimin e akteve në fushën e vet	91%	5
31	Përfshin përfaqësues të organizatave qytetare në përcjelljen dhe vlerësimin e akteve	45%	3
<b>Shpall raporte për përcjelljen dhe vlerësimin e akteve në këto forma:</b>			
32	Format elektronik (adresa (URL) e ueb-faqes)	18%	1
33	Format i botuar (p.sh. publikim etj.)	18%	1
34	Shpall raport me informata për përfshirjen e publikut dhe ndikimin e komenteve	9%	1
35	Në fund të përgatitjes së akteve në memorandum gjithmonë informon për përfshirjen dhe bashkëpunimin me publikun e interesuar	64%	4
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2,5</b>

Edhe institucionet e tjera e ndjekin dhe e vlerësojnë zbatimin e akteve në fushën e vet por me një përfshirje më të vogël të organizatave qytetare (33%). ARS-ja është e vetmja e cila shpall raport me informacione për përfshirjen e publikut dhe ndikimin e komenteve.

**TABELA 8. Ndjekja dhe vlerësimi (Institucionet e tjera)**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultate (n=6)	Nota
<b>Institucioni:</b>			
30	E ndjek dhe e vlerëson zbatimin e akteve në fushën e vet	83%	5
31	Përfshin përfaqësues të organizatave qytetare në përcjelljen dhe vlerësimin e akteve	33%	2
<b>Shpall raporte për përcjelljen dhe vlerësimin e akteve në këto forma:</b>			
32	Format elektronik (adresa (URL) e ueb-faqes)	33%	2
33	Format i botuar (p.sh. publikim etj.)	33%	2
34	Shpall raport me informata për përfshirjen e publikut dhe ndikimin e komenteve	17%	1
35	Në fund të përgatitjes së akteve në memorandum gjithmonë informon për përfshirjen dhe bashkëpunimin me publikun e interesuar	50%	3
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2,5</b>

### 2.2.3. Fusha C: Përgatitja e akteve/ projekt-ligjeve

Transparenca e procesit të akteve (projekt-ligjeve dhe projekt-ligjeve për ndryshim dhe plotësim të ligjeve) është analizuar nga disa aspekte:

- Mënyra e shpërndarjes së informacioneve për procesin e përgatitjes së projekt-ligjeve;
- Qasja e teksteve eksperte nga fusha për të cilën është projekt-ligji;
- Korniza kohore për konsultim;
- Rrjedhja e zbatimit të procedurës së përgatitjes së projekt-ligjit;
- Reagimi i ministrive ndaj propozimeve dhe komenteve të sektorit civil.

## 2,6

është nota mesatare e përgjithshme për transparencën e proceseve të përgatitjes së 26 akteve në 12 ministri.

#### 2.2.3.1. Mënyra e shpërndarjes së informacioneve për procesin e përgatitjes së projekt-ligjeve

Kanali më i shfrytëzuar për informimin e publikut për fillimin e procedurës për përgatitjen e projekt-ligjit është nëpërmjet portaleve të ENER dhe e-demokratija. Kjo ishte dhënë në 73% të akteve të cilat janë analizuar. Shumë më pak ministri i shfrytëzojnë ueb-faqet e veta për lajmërim – në 27% të akteve të analizuar, edhe pse obligimi ligjor sipas paragrafit 1 të nenit 71 të rregullores së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë thotë: *“Propozimet për miratim të ligjeve, skicat dhe propozimet e ligjeve, ministria kompetente i shpall në faqen e vet të internetit dhe në Regjistrin e Vetëm Elektronik të Dispozitave (RVED)”*. Për 58% të akteve informacioni është shpërndarë nëpërmjet planit strategjik dhe Programit vjetor për punën e qeverisë, kurse 46% e akteve me dërgim direkt të informacionit te palët e interesuara. Vetëm në rastin e projekt-ligjit për mbrojtje shëndetësore, për të cilin është kompetente Ministria e Shëndetësisë (MSh), informacioni është shpallur në gazetë ditore. Ministria për këtë ligj në fillim ka organizuar edhe punëtori të përbashkët me palët e interesuara ku është prezantuar koncepti (teksti i punës i ligjit), arsyet, qëllimet dhe korniza kohore për miratim.

**TABELA 9.** Mënyra të informimit të publikut për fillimin e procedurës së përgatitjes së aktit

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=23)	Nota
<b>Ministria e ka informuar publikun për fillimin e procedurës për përgatitje të projekt-ligjit:</b>			
1	Me shpallje në planin strategjik dhe në programin vjetor për punën e Qeverisë	58%	3
2	Me shpalljen e informacionit në ueb-faqen e ministrisë	27%	2
3	Me informacion të dërguar te të gjitha palët e prekura (p.sh. postë direkte, postë elektronike)	46%	3
4	Me informacion për fillim të procedurës së shpallur në portal publik – ENER dhe e-demokratija	73%	4
5	Me shpallje të informacionit në gazetë ditore	4%	1
6	Me lloje të tjera për informim	4%	1
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2,33</b>



Në nenin 3 të Udhëzimit për mënyrën e veprimit në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën për përgatitjen e ligjeve është përcaktuar cilat informacione duhet të përmbajë lajmërim për informim të palëve të prekura për propozim për përgatitje të ligjit. Informacionet të cilat janë dhënë në mënyrë eksplicite në Udhëzim në pjesën më të madhe shpallen, prandaj vlerësimi i marrë për përmbajtjen e informacioneve është 3,46. Në 85% të ekzemplarëve të analizuar informacioni përmban emrin e projekt-ligjit dhe qëllimet e procedurës. Në 77% është dhënë korniza ligjore e evenimenteve më të rëndësishme dhe afatet e parapara për miratim të projekt-ligjit. Edhe pse sipas Udhëzimit informacioni duhet të përmbajë edhe mënyrë të përfshirjes së palëve të prekura në përgatitjen e projekt-ligjit, sipas rezultateve, më pak se gjysma (46%) e informacioneve përmbajnë metoda dhe mjete të parapara për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e publikut. Metodatat e mbledhjes dhe marrjes parasysh të mendimeve të publikut janë dhënë në 46% të informacioneve për fillim të procedurës së përgatitjes së aktit. Midis tjerash, është kontrolluar edhe se gjatë përgatitjes të projekt-ligjeve a përdoren studimet për çështjen përkatëse dhe a janë në dispozicion të publikut. Kështu, vetëm në tri raste janë në dispozicion informacionet e përmbledhura prej studimeve të cilat do ta ndihmonin publikun (aspekti laik): projekt-ligji për sigurim pensional dhe invalidor i MPPS, projekt ligji për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për Menaxhim me mbeturinat i MMJPH dhe projekt-ligji për konfiskim të pronës, dobi prone dhe objektet e marra në procedurë penale dhe kundërvajtës.

**TABELA 10. Përmbajtja e informacionit për fillim të procedurës për përgatitje të aktit**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultati (n=23)	Nota
<b>Informacioni për fillim të procedurës së përgatitjes së projekt-ligjit përmban:</b>			
7	Emri i projekt-ligjit	85%	5
8	Qëllimi i procedurës	85%	5
9	Korniza kohore e evenimenteve më të rëndësishme: identifikimi i fazave më të rëndësishme në procedurë	77%	4
10	Metoda dhe mjete të parapara për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e publikut	46%	3
11	Identifikim i palëve kryesore të prekura	69%	4
12	Në rastin e ekzistimit të studimeve mbi temën, a janë konsultuar ato dhe a ka informacione për publikun se ku t'i gjejë	23%	2
13	A ka dhe ku janë në dispozicion informacionet e përmbledhura prej studimeve të cilat do ta ndihmonin publikun (aspekti laik)	12%	1
14	Afatet e parapara për miratim të projekt-ligjeve	77%	4
15	Thirrje për përfshirje të publikut	50%	3
16	Shpenzime të parapara për procesin e përgatitjes së projekt-ligjit	54%	3
17	Të dhëna për kontakt (persona përgjegjës për përgatitjen e projekt-ligjit etj.)	81%	5
18	Metoda të mbledhjes dhe marrjes parasysh të mendimeve të publikut	46%	3
19	Ndjekje dhe vlerësim i procesit и оценка на процесот	42%	3
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>3,46</b>

### 2.2.3.2. Tekste eksperte nga fusha ku merret projekt-ligji

Në procesin e përgatitjes së ligjeve ministritë nuk e shfrytëzojnë sektorin qytetar si burim për ekspertizë në përgatitjen e teksteve profesioniste, sepse në asnjë prej proceseve të analizuara në përgatitjen e projekt-ligjeve analiza eksperte nuk është kërkuar të përgatitet nga organizatat qytetare. Në 27% të rasteve analiza eksperte është përgatitur nga firma konsultuese, personat ekspertë apo universitetet. Edhe pse ekzistojnë tekste eksperte të cilat mund të shfrytëzohen nga palët e prekura në procesin e përgatitjes së ligjeve, ato në 62% të rasteve janë në dispozicion (në formë të botuar) në ministri, vetëm në 155 apo vetëm në katër raste ato janë vendosur në ueb-faqen e ministrisë.

**TABELA 11. Qasja te tekstet eksperte**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultat (n=23)	Nota
<b>Tekstet eksperte për përgatitjen e projekt-ligjeve (studime, analiza, pasqyrime etj.):</b>			
20	Janë në dispozicion në ueb-faqen e ministrisë	15%	1
21	Janë në dispozicion (në formë të botuar) në ministri	62%	4
22	Përmbajnë pjesë të përmbledhura për publikun e përgjithshëm (jo ekspert)	23%	2
23	Ministria ka porositur tekste eksperte:		
	- Nga organizata qytetare	0%	1
	- Nga subjekte të tjera të dakorduara (firma konsultuese, persona ekspertë, universitete)	27%	2
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2</b>

### 2.2.3.3. Korniza kohore për konsultime

“Ministritë duhet rregullisht t’i shpallin versionet e projekt-ligjeve në ueb-faqen e vet dhe të ENER-it menjëherë pas përpunimit të çdo versioni. Gjithashtu edhe versionet e mëparshme të dokumenteve që lidhen me projekt-ligjin duhet të jenë në dispozicion.”<sup>3</sup> Ministritë kanë marrë notën 5 për shpalljen e projekt-ligjeve për konsultime në versionin e parë të punës së projekt-ligjit të dalë nga Ministria, përkatësisht notën 4 për shpalljen e versionit të projekt-ligjit pas harmonizimit midis sektorëve. Për afatin e lënë për marrjen e propozimeve dhe komenteve me shkrim për projekt-ligjin, nga sektori civil, ministritë kanë marrë notë 2 sepse më shumë akte, 10 (38%) janë lënë për komentim në afat prej 10 deri 15 ditësh, që korrespondon me minimum 10 ditë për konsultime sipas Rregullores së Qeverisë, por është më pak se praktika ndërkombëtare dhe afatet e parapara në Udhëzimin. Vetëm në një rast ai afat ishte më i gjatë se 30 ditë, kurse kjo ishte për projekt-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për menaxhim me mbeturinat të MMJPH-së.

3 Emina Nuredinoska, Igor Vidaçak, Transparenca në procesin e përgatitjes së ligjeve: Rregulla dhe praktika për përfshirjen e publikut me fokus në informacionin kthyes së komenteve nga publiku, OSBE, 2012



**TABELA 12. Korniza kohore për konsultime**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultat (n=23)	Nota
24	Për konsultime, projekt-ligji shpallet si:		
	- Versioni i parë i punës i dalë nga Ministria	85%	5
	- Projekt-ligj pas harmonizimit ndërmjet sektorëve	77%	4
25	Afatet për zbatim të propozimeve dhe komenteve me shkrim për projekt-ligjin nga sektori civil ishin:	34%	2
	- Më e gjatë se 30 ditë nga ditët e punës		
	- Nga 15 deri 30 ditë pune		
	- Nga 10 deri 15 ditë		
	- Më pak se 10 ditë		
	- Nuk kishte mundësi për propozime dhe komente		
26	A keni organizuar evenimente për konsultime (fizike apo ueb-faqe) gjatë përgatitjes së projekt-ligjeve, kur keni dërguar ftesë për pjesëmarrje në konsultime?	24%	2
	- Më tepër se 15 ditë para evenimentit		
	- Prej 7 deri 15 ditë		
	- Më pak se 7 ditë		
	- Nuk organizojmë eveniment të tillë		
27	Kur vendoset afati për konsultime a merrni parasysh festat dhe datat e tjera të rëndësishme për atë periudhë?	58%	3
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>3,2</b>

#### **2.2.3.4. Rrjedhja e zbatimit të konsultimeve në procedurën e përgatitjes së projekt-ligjit**

Nota mesatare gjatë zbatimit të konsultimeve në procedurën e përgatitjes së projekt-ligjeve për aktet e analizuara është 2. Në 69% të akteve të analizuara është emëruar person i cili jep informacione për përgatitjen e projekt-ligjeve dhe për përfshirjen e publikut në procedurë. Në fazën e hershme kur formulohen tezat/parimet e projekt-ligjeve, publiku është përfshirë në 35% të akteve, kurse në 38% janë prezantuar edhe zgjidhje të ndryshme për përmbajtjen e projekt-ligjit. Në tri raste të projekt-ligjeve është mundur moderim i pavarur i evenimenteve për përfshirje të publikut në proceset e përgatitjes

së projekt-ligjit: Ligji për Ndryshme dhe Plotësime të Ligjit për Siguri në Qarkullimin e Rrugëve (MPB), projekt-ligji për material të arkivuar (MSHIA) dhe projekt-ligji për shpallje të tërësisë përkujtimore të Krushevs për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë (MK).

**TABELA 13.** Rrjedhja e zbatimit të konsultimeve

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultat (n=23)	Nota
<b>Ministria:</b>			
28	Emëron person i cili jep informacione për përgatitjen e projekt-ligjit dhe për përfshirjen e publikut në procedurë	69%	4
29	Mundëson përfshirje të sektorit civil në fazën e hershme kur formulohen tezat/parimet e projekt-ligjit	35%	2
30	Në procesin e përgatitjes së projekt-ligjit organizon evenimente për përfshirje të publikut, si debate publike, tryeza të rrumbullakët etj.	19%	1
31	Mundëson moderim të pavarur të evenimenteve për përfshirjen e publikut në procesin e përgatitjes së projekt-ligjit (p.sh. facilitues nga një institucion tjetër, person të jashtëm ekspert etj.)	12%	1
32	Në fazën e hershme publikut i prezantohen zgjidhjet e ndryshme për projekt-përmbajtjen e projekt-ligjit	38%	2
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>2</b>

#### 2.2.3.5. Reagimi i ministrisë ndaj propozimeve dhe komenteve të sektorit civil

Notë të ulët (1,5) ministrinë kanë marrë për përgjigjet e tyre për propozimet dhe komentet e marra nga sektori civil. Rezultatet dëshmuar se ministrinë shumë rrallë japin informacione kthyesë, përkatësisht mendime për propozimet dhe komentet e arritura nga sektori civil, kështu në 6 raste (23%) kanë dhënë mendimin e vet si informacion të përbashkët, kurse vetëm në 4 raste (915%) kanë dhënë mendimin e vet për çdo propozim të veçantë. Obligimi, nga ana tjetër, është në bazë të nenit 71, paragrafi 5 i Rregullores së Qeverisë sipas të cilit çdo ministri duhet të përgatisë raport për mendimet e marra në të cilat duhet të jepen arsyet cilat vërejtje dhe propozime nuk janë pranuar dhe ata të vendosen në internet-faqen e ministrisë përkatëse dhe në ENER. Vetëm për dy akte (8%) ministrinë kanë përgatitur raporte kthyesë: MSh – projekt-ligji për mbrojtje shëndetësore dhe MD – projekt-ligj për të drejtat e fëmijëve. Po për kaq akte ministrinë në ueb-faqen e vet i shpallën komentet, propozimet dhe argumentet e dhëna nga sektori civil, dhe kjo në rastin e projekt-ligjit për ndalim të vlefshmërisë së Ligjit për të





drejtat e anëtarëve të familjes kryefamiljari i të cilës është ushtar në shërbim të afatit ushtarak (MPPS) dhe projekt-ligji për shpalljen e monumentit përkujtimor të Krushevës për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë (MK). Nuk ekzistonte rasti kur ndonjë ministri ka shpallur informacion të botuar për komentet, propozimet dhe argumentet e sektorit civil për projekt-ligjin.

Më pak se gjysma (46%) e akteve, informacionet për publikun e përfshirë në procesin konsultues është vendosur në memorandumin e projekt-ligjit, që është obligim sipas ekzemplarëve për PVR.

**TABELA 14. Reagimi i ministrive**

Nr.	Titulli i indikatorit	Rezultat (n=23)	Nota
<b>Reagimi i ministrisë ndaj propozimeve dhe komenteve të sektorit civil</b>			
33	Ministria për propozimet e arritura të sektorit civil:		
	- Nuk ka dhënë mendimin e vet	73%	4
	- Ka dhënë mendimin e vet si informacion i përbashkët	23%	2
	- Ka dhënë mendimin e vet për çdo propozim më vete	15%	1
34	Ministria ka përgatitur raport kthyes për sektorin qytetar	8%	1
35	Ministria në ueb-faqen e vet i ka shpallur komentet, propozimet dhe argumentet e dhëna nga sektori civil	8%	1
36	Ministria shpall informacion të botuar për komentet, propozimet dhe argumentet e sektorit civil për projekt-ligjin	0%	1
37	Në memorandumin e projekt-ligjit ka informacione për përfshirjen e publikut në procesin konsultues	46%	3
<b>NOTA MESATARE</b>			<b>1,5</b>

### 2.2.4. Reagimi i sektorit civil

Ministritë janë pyetur që t'i vlerësojnë propozimet e arritura nga organizatat qytetare me një seri pyetjesh të dhëna më poshtë.

**TABELA 15.** Reagimi i sektorit civil

Titulli i indikatorëve	
38	Ministritë në përgatitjen e projekt-ligjit përfundimtar i përfshijnë propozimet dhe komentet e sektorit civil
39	Cilat janë vlerësimet e propozimeve dhe komenteve të sektorit civil, sipas shikimit të ministrisë:
	- Në pjesën më të madhe janë relevante në raport me përmbajtjen dhe ekspertizën
	- Pjesërisht janë relevante, kurse pjesërisht nuk janë
	- Pothuajse të gjitha nuk janë relevante
	- Nuk marrim komente dhe propozime nga sektori civil
40	Ministria gjatë përgatitjes së projekt-ligjit:
	- Është e kënaqur me reagimin e publikut
	- Nevojitet reagim më i madh nga publiku
	- Nuk ka mendim për bashkëpunim me publikun

Në përgatitjen e projekt-ligjit përfundimtar propozimet dhe komentet e sektorit civil janë përfshirë vetëm në katër akte: projekt-ligji për shpallje të monumentit të Krushevës për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë (MK), projekt-ligji për standardin studentor (MASH), projekt-ligji për sigurim pensional dhe invalidor (MPPS) dhe Ligji për shërbimin publik të prokurorisë (MD). Në tri raste propozimet dhe komentet janë vlerësuar si relevante në pjesën më të madhe të përmbajtjes dhe ekspertizës, kurs enë rastin e Ligjit për shërbimin e prokurorisë propozimet janë vlerësuar si pjesërisht relevante. Ministritë japin arsye të ndryshme pse nuk i kanë përfshirë propozimet e sektorit civil. Si arsye për mospërfshirje MASH-ja për dy ligje (projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për arsimin tetëvjeçar dhe



projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për arsimin e mesëm) i jep afatet kohore, përkatësisht urgjencën për miratimin e tyre dhe fillimin me ato, kurse në rastin e projekt-ligjit për standardin studentor propozimet janë përfshirë sepse ishin të përmbajtura, të tërësishme dhe me konstrukcion financiar. MShIA si arsye për mospërfshirjen e propozimeve dhe komenteve në përgatitjen e projekt-ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për komunikime elektronike thotë se bëhet fjalë për harmonizim të Ligjit me direktivat e BE-së.

MMJPH si shkak për mospërfshirjen e propozimeve me shkrim jep arsyen se nuk kanë mbërritur komente nga sektori qytat, kurs enë rastin kur është organizuar debati publik për projekt-ligjin për menaxhim të mbeturinave, komentet e përfaqësuesve të pranishëm të organizatave qytetare ishin në drejtim të mbështetjes së tekstit të propozuar të ligjit.

Ajo që shqetëson është fakti se në 23% të rasteve ministrinë janë të kënaqura me reagimin e publikut dhe gjithashtu po kaq konsiderojnë se është e nevojshme reagim më i madh i publikut. Pjesa tjetër e mbetur që është pak më shumë se gjysma (54%) nuk kanë mendim për bashkëpunimin me publikun.

### 2.3. Rezultatet sipas ministrive

Në këtë pjesë do të prezantohen vlerësimet e ministrive dhe institucioneve të tjera sipas fushave të transparencës:

1. Fusha A dhe B: Komunikimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përfshirjen e shoqërisë civile në punën e vet;
2. Fusha C: Përgatitja e akteve.

Në pjesën e parë janë dhënë pikët për secilën ministri dhe institucion për katër karakteristikat me të cilat vlerësohet mjedisi i përgjithshëm komunikues dhe mbështetja për përfshirjen e shoqërisë civile në punën e tyre: vendosja institucionale, mjedisi mbështetës, mjedisi financiar dhe ndjekja dhe vlerësimi i zbatimit të akteve (fusha A dhe B). Për atë se cilët indikatorë përmbahen në secilën prej fushave, mund të shihet Pjesa 2.2. – Rezultatet sipas indikatorëve për transparencën e institucioneve.

Pastaj vijon vlerësimi i procesit të përgatitjes (fusha C) së 26 akteve të 12 ministrive dhe ky vlerësim për çdo akt dhe notë mesatare për ministrinë.

Në fund janë dhënë notat e përgjithshme për ministrinë për të tri fushat, por vetëm për ato ministri të cilat u janë përgjigjur të dy pyetësorëve, përkatësisht të cilat kanë vlerësim për të gjitha fushat.

#### 2.3.1. Fushat A dhe B: Komunikimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përfshirjen e shoqërisë civile në punën e vet

Katra (4) është nota më e lartë që kanë marrë ministrinë për mjedisin komunikues dhe mbështetës për përfshirjen e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve dhe ato janë: MPPS, MK dhe MASH. Pesë ministri kanë marrë notën 3 (3) dhe tri ministri janë vlerësuar me dy (2). Në Tabelën 16 janë dhënë pikët për secilën ministri për katër karakteristikat e komunikimit të përgjithshëm dhe mbështetjes për përfshirjen e shoqërisë civile dhe nota e përgjithshme.

**TABELA 16.** Fusha A dhe B: Komunikimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përfshirjen e shoqërisë civile (ministri)

Rezultate sipas ministrive (maks. 35 pikë)	Pikë të përgjithshme	Vendosja institucionale (pikë)	Mjedisi mbështetës (pikë)	Mjedisi financiar (pikë)	Ndjeje dhe vlerësim i zbatimit (pikë)	Nota
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	24	10	7	4	3	4
Ministria e Kulturës	23	11	4	5	3	4
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	22	11	4	2	5	4
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit të Hapësirës	21	9	7	3	2	3
Ministria e Drejtësisë	19	11	5	0	3	3
Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	16	10	3	0	3	3
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	16	9	5	0	2	3
Ministria e Mbrojtjes	15	6	3	4	2	3
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	14	9	3	0	2	2
Ministria e Punëve të Brendshme	13	9	2	0	2	2
Ministria e Ekonomisë	11	7	2	2	0	2



Te institucionet tjera, Agjencia për të Rinjtë dhe Sport është e vetmja me notën 5, pastaj vijon KMD, SÇE dhe SZMK me notë 3.

**TABELA 17.** Fusha A dhe B: Komunikimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përfshirje të shoqërisë civile (institucione të tjera)

Rezultate sipas institucioneve (maksimum 27 pikë)	Pikët e përgjithshme	Mekanizma të përgjithshëm	Mjedisi mbështetës	Mjedisi financiar	Ndjekje dhe vlerësim i zbatimit	Nota
Agjencia për të Rinjtë dhe Sport	24	10	6	4	4	5
Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi	14	7	1	1	5	3
Sekretariati për Çështje Evropiane	13	6	6	1	0	3
Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (SIOFA)	11	4	3	2	2	3
Komisioni Shtetëror për Pengimin e Korrupsionit (KShPK)	9	3	3	0	3	2
Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Fetare	6	4	1	0	1	2

### 2.3.2. Fusha C: Përgatitja e akteve

Asnjë prej akteve të analizuara nuk ka marrë notën pesë (5) për transparencë në procesin e përgatitjes së ligjit. Nota më e lart është katër (4) dhe kjo notë është për projekt-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për menaxhim me mbeturinat të MMJPH-së dhe projekt-ligjit për mbrojtje shëndetësore të MSh-së. Notën tre (3) e kanë marrë 12 akte, kurse tetë akte janë vlerësuar me dy (2). Katër akte kanë marrë notën 1. Në Tabelën nr. 18 janë dhënë notat për çdo akt. Në rangun e ministrive në listë udhëheq MSh me notën 4, kurse pastaj vijon MMJPH dhe MPPS dhe MD. Megjithatë duhet të merret parasysh se nota për MSh-në është marrë në bazë të analizës për një ligj, për dallim prej ministrive të tjera për të cilat janë analizuar shumë ligje.

**TABELA 18.** Fusha C: Përgatitja e akteve

Ministria	Akti (projekt-ligji)	Pikë të përgjithshme	Nota për akt	Mesatare e pikëve	Nota
<b>Ministria e Shëndetësisë</b>	Për mbrojtjen shëndetësore	29	4	29	4
<b>Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor</b>	Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për M=menaxhim me mbeturinat	33	4	27	3
	Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujërat	21	3		
<b>Ministria e Drejtësisë</b>	Për pronë të konfiskuar, dobi pronësore dhe objekte të marrë në procedurë penale dhe kundërvajtjeje	22	3	22,7	3
	Për të drejtat e fëmijëve	21	3		
	Ligji për shërbimin publik të prokurorisë	25	3		
<b>Ministria e Punës dhe Politikës Sociale</b>	Për ndryshim të Ligjit për familjen	17	2	21,0	3
	Për ndryshim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve	18	2		
	Për përfundimin e vlefshmërisë së Ligjit për të drejtat e anëtarëve të familjeve, kryetari i cilës është ushtarak në shërbim ushtarak	22	3		
	Për sigurim pensional dhe invalid	27	3		
<b>Ministria e Arsimit dhe Shkencës</b>	Për ndryshim dhe plotësim të arsimit të mesëm	17	2	20,0	3
	Për ndryshim dhe plotësim të arsimit tetëvjeçar	16	2		
	Për standardin studentor	27	3		
<b>Ministria e Shoqërisë Informatike dhe administratës</b>	Për material arkivi	22	3	19,5	3
	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për komunikime elektronike	17	2		
<b>Ministria e kulturës</b>	Për shpallje të monumentit përkujtimor të Krushevës për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë	19	3	19,0	3
<b>Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujërave</b>	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për cilësinë e prodhimeve bujqësore	19	3	19	3
<b>Ministria e Ekonomisë</b>	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për standardizim	19	3	15,5	2
	Për tregti në tregjet e gjelbra	12	2		
<b>Ministria e Punëve të Jashtme</b>	Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për punët e jashtme	15	2	15,0	2
<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për armët	6	1	14,3	2
	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për siguri të qarkullimit të rrugëve	23	3		
	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përcjellje të komunikimeve	14	2		
<b>Ministria e Transportit dhe Lidhjeve</b>	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për pastërtinë publike	2	1	2,3	1
	Për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të aviacionit	2	1		
	Për veprimtari komunale	3	1		



### 2.3.3. Rezultatet e përgjithshme

Në këtë pjesë është dhënë nota e përgjithshme e ministrive për dy pyetësorët (i përgjithshmi dhe për aktet e veçanta). Qëllimi i prezantimit të tillë është që të eliminohet ndikimi i pikëpamjes së përgjithshme apo shumë specifike (në nivelin e akteve) rezultati është dhënë vetëm për ministrinë të cilët u kanë dhënë përgjigje të dy pyetësorëve.

Në rezultatin e përgjithshëm, nota më e lartë e ministrive është tre (3). Gjashtë ministri kanë notën tre (3), dy ministri kanë dysh (2) dhe vetëm një ministri ka notën një (1). Ministrinë të vlerësuara më mirë janë MMJPH, MPPS, MK, MASH, MD dhe MShIA. MMJPH është një prej tri ministrive (përveç MPPS dhe MD) e cila publikut i jep në formë të përmbledhur informacionet e studimeve të cilat do t'i shfrytëzojnë aktivisht në përgatitjen e ligjeve. Gjithashtu projekt-ligji i tyre për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Menaxhim me mbeturinat është i vetmi prej akteve të analizuar i cili është lënë 30 ditë në konsultim me publikun. Gjithashtu kjo ministri, përveç MShIA dhe MD i mundëson publikut të interesuar të regjistrohet në regjistrin për marrjen e informacioneve. MMJPH, MPPS dhe MShIA kanë regjistër ku mundet hapur të regjistrohen organizatat qytetare (për marrje të rregullt të informacioneve). Për shembull, MMJPH këtë e bën nëpërmjet formularit për azhurnim të të dhënave për organizatat qytetare në Maqedoni të cilat veprojnë në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, i cili është vendosur në faqen kryesore të ueb-faqes së tyre. Gjithashtu MMJPH, MD dhe MM kanë paraparë procedurë për përzgjedhjen e organizatave qytetare kur numri për pjesëmarrje është i kufizuar. MASH dhe MMJPH janë të vetmet të cilat i vendosin raportet e ndjekjes dhe vlerësimit të akteve në formë elektronike në ueb-faqe. MPPS, MASH dhe MK janë të vetmet të cilat kanë mjete për mbulim të shpenzimeve të pjesëmarrësve nga sektori civil në organet e punës dhe këshillëdhënëse. MPPS dhe MD janë ministrinë e vetme të cilat kanë dokument të mëvetëshëm të shkruar (drejtime) për përfshirjen e organizatave qytetare. MASH, MShIA, MD dhe MK kanë praktikë të përdorin e-pyetësorë për marrjen e mendimit të publikut për çështje të përgjithshme apo për procese konkrete.

**TABELA 19.** Rezultati i përgjithshëm

Rezultati sipas ministrive	Pikë për mjedisin (maksimum 35)	Pikë për procedurat konkrete (maksimum 45)	Pikë të përgjithshme (maksimum 80)	Nota
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	21	27	<b>48</b>	<b>3</b>
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	24	21	<b>45</b>	<b>3</b>
Ministria e Kulturës	23	19	<b>42</b>	<b>3</b>
Ministria e Arsimit dhe Shkencës	22	20	<b>42</b>	<b>3</b>
Ministria e Drejtësisë	19	22,7	<b>41,7</b>	<b>3</b>
Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	16	19,5	<b>35,5</b>	<b>3</b>
Ministria e Punëve të Brendshme	13	14	<b>27</b>	<b>2</b>
Ministria e Ekonomisë	11	15	<b>26</b>	<b>2</b>
Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	14	2,3	<b>16,3</b>	<b>1</b>

## 2.4. Përfundime dhe rekomandime

Në Analizë janë përfshirë 11 ministri dhe 6 institucione të tjera. Janë dhënë 75 indikatorë me të cilët arrihet përgjigjja për dy tërësi: praktika të komunikimit të institucioneve dhe shkalla e transparencës; dhe përfshirja e publikut në proceset e përgatitjes së projekt-ligjeve konkrete konsultimet për të cilat kanë përfunduar më 30 shtator 2012.

### 2.4.1. Përfundime

**1. Ekzistojnë mekanizma të vendosur mirë dhe praktika për komunikim me sektorin qytetar dhe publikun, por mungon pro aktiviteti.** Nota mesatare për komunikimin e përgjithshëm të ministrive me publikun dhe organizatat qytetare është 3,47. Ministrinë më shpesh i plotësojnë obligimet e dhëna me ligj, rregullore apo akte të tjera. Kështu të gjitha ministrinë kanë emëruar person përgjegjës për dhënie të informacioneve me karakter publik dhe koordinator për vlerësim të ndikimit të rregullativës. Gjithashtu të gjitha e përdorin ENER për shpalljen e projekt-akteve, kurse nuk i shpallin të gjitha aktet në ueb-faqet e veta. Nga ana tjetër, propozimet dhe komentet e marra nga publiku i interesuar në lidhje me punën e ministrive edhe në procese të caktuara konkrete rrallë shpallen në ueb-faqet e ministrive. Praktika e tillë kontribuon vetëm në zbatimin e standardeve minimale të vendosura, kurse përpjekjet për qasje proaktive nga institucionet për informim dhe përfshirje të publikut dhe sektorit civil në punën e tyre mungon.

**2. Mjedisi mbështetës për pjesëmarrje të publikut në përgatitjen e ligjeve është i pakënaqshëm.** Nota mesatare për tri fushat e analizuar: vendosja institucionale, mbështetja financiare dhe përfshirja në përcjelljen e zbatimit të akteve është 2,65.

- Nota më e lartë për tri nënfshat e analizuar është 3,13 për **kornizën institucionale** për përfshirjen e sektorit civil në punën e ministrive. Pothuajse të gjitha ministrinë (91%) kanë emëruar person për bashkëpunim me organizatat qytetare dhe përshijnë përfaqësues të organizatave qytetare në organet konsultuese dhe komisionet e ministrive. Megjithatë, bashkëpunimi dhe përfshirja nuk bazohet në rregulla sistematike dhe procedura, sepse vetëm një ministri ka dokument të veçantë të shkruar (drejtime) për përfshirjen e organizatave qytetare, vetëm dy ministri kanë paraparë procedurë për përzgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri i pjesëmarrësve është i kufizuar, ndërsa vetëm tri ministri kanë regjistruar hapur mund të regjistrohen organizatat qytetare që të marrin rregullisht informacione.
- Është marrë notë e ulët mesatare prej 2,17 për **mjedisin financiar** për mbështetje të **sektorit civil**, që ka të bëjë me faktin se vetëm gjysma e ministrive kanë mjete për financim të projekteve dhe programeve për organizatat qytetare, kurse asnjë ministri nuk ka parashikuar mjete për mbështetje profesionale për pjesëmarrje dhe përfaqësim të organizatave qytetare në proceset e përgatitjes së ligjeve.
- Ministrinë edhe pse e **ndjekin dhe e vlerësojnë zbatimin e akteve në fushën e vet (91%)**, më pak se gjysma e tyre, përkatësisht 45% përfshijnë organizata në procesin e ndjekjes dhe vlerësimit të akteve si në formë elektronike ashtu edhe në formë të botuar, kurse vetëm një ministri ka shpallur raport kthyes për përfshirje të publikut dhe ndikimit të komenteve për përcjelljen e zbatimit të akteve në kompetencat e veta.





### **3. Transparenca e proceseve gjatë përgatitjes së akteve konkrete është vlerësuar si e pamjaftueshme, përkatësisht me notë 2,6.**

- Për 26 aktet e analizuarra kanali më i dobishëm për informim të publikut për fillimin e procedurës për përgatitje të projekt-versioneve të tyre janë portalet ENER dhe e-demokratija (në 73% të rasteve). Nga ana tjetër, ministrinë nuk i shfrytëzojnë sa duhet ueb-faqete veta për lajmërim të publikut për përgatitje të akteve. Projekt-ligjet që vendosen për konsultime zakonisht janë në versionin e parë të punës të dalë nga ministria (85%) apo pas harmonizimit midis sektorëve (77%). Kurse në një numër më të vogël mundësohet përfshirje e sektorit civil në fazën e hershme kur formulohen tezat/parimet e projekt-ligjeve (35%).
- Sektori civil nuk njihet si burim ekspertize dhe njohurie. Domethënë, në asnjë prej proceseve të analizuarra të përgatitjes së projekt-ligjeve analiza eksperte nuk është kërkuar të përgatitet nga ndonjë organizatë qytetare.
- Respektimi i afateve kohore për konsultime është vlerësuar si e kënaqshme me notë 3,2. Shpallja e projekt-ligjeve është vlerësuar me 5, përkatësisht 4 (për projekt-versionin e parë dhe për versionin pas harmonizimit midis sektorëve), por notë të ulët mesatare 2 ministrinë kanë marrë për përmbajtjes së tyre ndaj afatit minimal prej 10 ditësh për marrje të propozimeve me shkrim dhe komenteve për projekt-ligjin nga ana e publikut.
- Rezultatet dëshmojnë se ministrinë shumë rrallë japin **informacione kthyesë**, përkatësisht mendime për propozimet dhe komentet e arritura nga sektori civil, për çka janë vlerësuar me 1,5. Ministrinë shumë rrallë përgatisin raport kthyes për sektorët qytetarë, por as nuk i botojnë komentet, propozimet dhe argumentet e dhëna nga sektori civil.

**4. Ministri të caktuar veçohen si udhëheqës në praktikat pozitive në të gjitha fushat e analizuarra.** MMJPH ka marrë notën e përgjithshme më të lartë kurse tek e njëjta janë vënë re nota mbi mesatare në komunikimin e përgjithshëm me publikun, kurse gjithashtu edhe në proceset e përgatitjes së akteve konkrete. Praktika pozitive ndiqen edhe nga MPPS, MK, MASH dhe MD.

#### **2.4.2. Rekomandime**

##### **1. Nevojitet proaktivitet o zmadhuar për komunikim me publikun e interesuar dhe me sektorin qytetar.**

Është e nevojshme ministrinë dhe institucionet të respektojnë minimum standardin për informim dhe interaksion me publikun dhe sektorin qytetar. Shtesë, për transparencë më të madhe dhe besim më të madh, është e nevojshme qasja e tyre proaktive dhe përdorimi dhe gjetja e mënyrave të ndryshme për komunikim përkatëse me nevojat e grupeve qëllimore. Në këtë drejtim është e nevojshme kërkesat dhe komentet nga ana e publikut të prekur, si dhe mendimet për të njëjtat të shpallen në mënyrë publike.

##### **2. Nevojitet të përmirësohet mjedisi mbështetës për pjesëmarrjen e publikut në proceset e përgatitjes së ligjeve.**

- Nevojitet përmirësim i kornizës institucionale në disa drejtime, si: ministri, përkatësisht institucionet e tjera shtetërore duhet të përgatitin dokument të veçantë të shkruar (drejtime) për përfshirjen e organizatave qytetare në proceset e përgatitjes së ligjeve në kompetencat e tyre. Gjithashtu është e nevojshme të përcaktohen procedura dhe kriteret për zgjedhje të përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri për pjesëmarrje është i kufizuar. E dobishme

për informim dhe përfshirje më të madhe të sektorit civil do të ishte kur ministritë, përkatësisht institucionet do të mundësonin regjistrim vullnetar të organizatave për të marrë rregullisht informacione në regjistra të veçantë në dispozicion në ueb-faqet e ministrive.

- Është e domosdoshme në nivel të ministrive të sigurohen mjete më të mëdha financiare për mbështetje të sektorit civil nëpërmjet financimit të programeve dhe projekteve të organizatave qytetare, si dhe nëpërmjet përcaktimit të mjeteve për mbështetje profesionale dhe për përfaqësim të organizatave qytetare (si për shembull, konsultime juridike dhe mbështetje informatike).
- Rezultatet, përkatësisht raportet e ndjekjes dhe çmimit të zbatimit të akteve duhet rregullisht të shpallen në formë elektronike ose të botuar nga ministritë. Në procesin e ndjekjes është e nevojshme përfshirja e rregullt e sektorit civil, kurse gjithashtu është e domosdoshme dhënia e raportit kthyes për përfshirjen e sektorit civil dhe kontributi i tij në proceset e ndjekjes dhe vlerësimin të zbatimit të ligjeve.

### **3. Është e nevojshme përdorim i përmirësuar i mekanizmave ekzistues për përfshirjen e publikut në përgatitjen e çdo projekt-ligji me qëllim që të sigurohen ligje përkatëse me nevojat e grupeve qëllimore dhe publikut të gjerë.**

- Proceset konsultuese në përgatitjen e projekt-ligjeve duhet t'i fillojnë në fazën e hershme kur formulohen tezat/parimet e projekt-ligjeve. Dokumentet relevante lidhur me projekt-ligjin konkret, siç është Plani i Punës, PVR-ja initiale, PVR-ja complete duhet të shpallen rregullisht menjëherë pas përgatitjes së tyre në ENER dhe ueb-faqet e ministrive. Gjithashtu, të gjitha versionet e projekt-ligjit duhet të shpallen në kohë dhe të dorëzohen për mbikëqyrje publike në të gjitha fazat.
- Nevojiten aktivitete për ngritjen e vetëdijes së ministrive që ta njohin ato **sektorin qytetar si burim i ekspertizës gjatë përgatitjes së projekt-ligjeve.**
- Nevojitet të mos lejohet shqyrtimi i ligjeve në seancën e Qeverisë nëse minimumi prej 10 ditësh për konsultime nuk është respektuar dhe nëse nuk është përgatitur raport përkatës prej konsultimeve. Shtesë, që të përmirësohet korniza kohore për konsultime, nevojitet harmonizim i afatit për konsultime në Rregulloren e Qeverisë me afat të paraparë në nenin 5 të Udhëzimit të vitit 2011<sup>4</sup> i cili është 30 ditë.

**4. Nevojitet ndarje e përvojave si nxitje për rregullativë më të mirë dhe zbatim të saj.** Praktikrat pozitive të cilat janë përcaktuar në disa ministri është e nevojshme të promovohen dhe ndahen me ministritë dhe institucionet e tjera. Prandaj, është e nevojshme të vendoset mekanizëm i rregullt për shkëmbimin e shembujve të mirë midis vetë nëpunësve shtetërorë, por gjithashtu edhe sektori civil duhet ta analizojë punën e institucioneve dhe njëkohësisht t'i prezantojë rezultatet dhe shembujt pozitivë të cilët për të tjerët do të shërbejnë si nxitje.

4 Udhëzim për mënyrën e veprimin në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën për përgatitjen e ligjeve.



## 3. REZULTATE NGA PËRCJELLJA NË INTERNET

### 3.1. Metodologjia dhe qasja

Përveç pyetësorëve si instrument për përcjelljen e transparencës së organeve të administratës shtetërore dhe institucioneve, është bërë edhe monitorim i internetit për ENER dhe ueb-faqet e ministrive për të cilat ekziston obligim ligjor ato të vendosin projekt-ligje në dispozicion për konsultime publike.

Monitorimi-internet përfshin dy pjesë:

- 1. Monitorim i ENER,** ku është ndjekur ruajtja e afatit kohor për konsultime për projekt-ligjet e botuara në përputhje me Rregulloren për punën e Qeverisë dhe afatit kohor sipas Udhëzimit<sup>5</sup>, si dhe dokumentet e përmbajtura dhe tërësia e tyre gjatë shpalljes së projekt-dispozitës;
- 2. Monitorim i ueb-faqeve të ministrive** ku është shqyrtuar shpallja e projekt-ligjeve dhe informimi i publikut për mundësinë e përfshirjes në përgatitjen e projekt-ligjeve.

#### 3.1.1. Ekzemplar

Në periudhën nga 1 marsi deri në 31 tetor 2012 në ENER janë shpallur 157 projekt-ligje gjithsej. Për të gjitha ato është kryer ndjekje e detajuar.

Ekzemplari për ndjekje i përfshiu vetëm projekt-ligjet, kurse aktet nënligjore nuk ishin objekt i ndjekjes, sepse legjislativi nuk parashikon obligim për shpalljen e tyre në mbikëqyrje publike.

Pjesa e dytë e ndjekjes në internet i përfshiu të dhënat për 15 ueb-faqet e ministrive në Republikën e Maqedonisë.

#### 3.1.2. Përpunimi dhe prezantimi i rezultateve

Prej të dhënave të nxjerra nga ENER, ueb-faqja e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe ueb-faqet e ministrive gjatë periudhës së ndjekjes janë krijuar shumë baza të dhënash. Rezultatet e përpunuara janë prezantuar në vijim me përdorim të tabelave dhe tregimeve grafike të shprehura në numra absolutë dhe me përqindje, ndiqen me komentet përkatëse dhe përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra.

#### 3.1.3. Kufizime metodologjike

Për shkak të automatizmit jo të tërësishëm të të dhënave të ENER dhe mungesës së një pjesë të informacioneve, analiza është bazuar në përcjelljen e shumë burimeve të ndryshme. Domethënë, tek ENER nuk mund të identifikohen qartë ndryshimet të cilat ndodhin pasi të botohet projekt-ligji në ueb-faqe, si dhe mbyllja e periudhës së konsultimeve. Që të përcaktohet dita e mbylljes së periudhës së konsultimeve, janë kërkuar informacione shtesë, para së gjithash në ueb-faqen e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Në bazë të materialeve në dispozicion në faqen e kuvendit, janë marrë të dhëna për datën kur është përcaktuar projekt-ligji në seancën e Qeverisë. Ajo datë është marrë si datë kur dispozita ka qenë e mbyllur për konsultime. Gjithashtu, në periudhën<sup>6</sup> e ndjekjes së ENER është regjistruar vetëm data e shpalljes së parë. Megjithatë problem shfaqet në datën e ndodhjes së ndryshimeve të caktuara

<sup>5</sup> Udhëzim për mënyrën e veprimit në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën e përgatitjes së ligjeve.

<sup>6</sup> Gjatë zbatimit të projektit 2.11.2012, MShIA e përmirëson dhe promovon ENER, sidomos në pjesën me regjistrimin e datës së ndryshimeve.

(ndryshim i statusit<sup>7</sup>, ndryshim /plotësim i dokumenteve) të cilat nuk regjistrohen, që në mënyrë shtesë e vështirësojnë përcjelljen e lëshimeve.

Përmirësimet të cilat ndodhën në ENER në shtator, midis të tjerash e regjistrojnë edhe datën e ndryshimeve dhe plotësimeve të ndodhura.

## 3.2. Monitorimi i ENER

Duke pasur parasysh përparësitë e konsultimeve elektronike të mundësuar nëpërmjet ENER, të cilat janë të kapshme për publikun e gjerë dhe financiarisht janë më pak ngarkuese për organet e administratës shtetërore, u shfaq nevoja për përcjelljen e këtij sistemi të rëndësishëm elektronik për përfshirjen e zmadhuar të publikut. Prej këndeje edhe nevoja e ndjekjes së tij të vazhdueshme me qëllim që të përcaktohen mangësitë të cilat e pengon cilësinë e përfshirjes së palëve të prekura në proceset e përgatitjes së ligjeve. Objekt i ndjekjes ishin, para së gjithash: ruajtja e afateve kohore ku projekt-ligjet ishin të kapshme për mbikëqyrje publike, kompleksiteti i dokumenteve, azhurnimi i informacioneve dhe praktika e dorëzimit të komenteve nga publiku.

### 3.2.1. Ruajtja e afatit kohor për konsultime sipas rregullores së Qeverisë dhe sipas Udhëzimit

Në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Metodologjia për vlerësim të ndikimit të rregullativës dhe Udhëzimit<sup>8</sup>, ministrinë propozimet për miratim të ligjeve, skicat dhe propozimet e ligjeve, përveç ligjeve të cilat miratohen me procedurë urgjente, duhet me patjetër t'i shpallin në ENER dhe ato të jenë në dispozicion për komente nga publiku 10 ditë nga dita e shpallje (sipas Rregullores), përkatësisht 30 ditë (sipas Udhëzimit). Në ENER secila prej palëve të interesuara mund të dorëzojë mendime, vërejtje dhe propozim në lidhje me propozimet e shpallura për miratim të ligjeve, skicave dhe propozimeve të ligjeve. Ministria kompetente është e obliguar të përgatisë raport për konsultimet e kryera dhe ta shpallë në uebfaqen e vet dhe në ENER.

Gjatë shpalljes së projekt-ligjit në ENER ai duhet të vendoset me status "I hapur", "Në vendim" dhe "I mbyllur". Statusi "I hapur" do të thotë se ligji është i hapur për konsultime nga publiku. Projekt-ligji duhet të kalojë në status "Në vendim" në momentin kur ka hyrë në procedurë qeveritare dhe në fund me status "I mbyllur" kur është miratuar në Kuvend.

Në periudhën e ndjekjes së ENER janë shpallur 157 projekt-ligje gjithsej. Prej tyre, 64 (41%) janë shpallur me status "I hapur", 75 (48%) janë shpallur direkt me status "Në vendim", kurse 18 (11%)

me status direkt "I mbyllur". Kjo do të thotë se të gjithë ligjet e shpallur në periudhën e ndjekjes 41% e ligjeve ishin vendosur për koment nga publiku. Pjesa më e madhe projekt-ligjeve të vendosura ka MF, 27 prej të cilave 26 (96%) me status "I hapur". Pas saj vijon Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujërave (MBPU) me 22 ligje dhe ME me 21 ligje të vendosura. Megjithatë në dy rastet e MBPU dhe ME vetëm një ligj ishte i hapur për komentim (i vendosur me status "I hapur"). MVL nuk ka shpallur asnjë projekt-ligj në periudhën e ndjekjes, me shpjegim se nuk ka pasur ndryshime në ligjet ekzistuese për të cilat është kompetente, kurse nuk ka pasur as ligje të reja. Në raport me numrin e ligjeve të cilat i ka shpallur një ministri e caktuar, MMJPH, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), MM dhe MF kanë më shumë projekt-ligje të cilat janë vendosur me status të hapur.

7 Status i mundshëm: „I hapur“, „Në vendim“ dhe „I mbyllur“.

8 Udhëzim për mënyrën e vendosjes në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën e përgatitjes së ligjeve, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 150 më 27.10.2011.



**TABELA 20.** Pasqyrimi i projekt-ligjeve të shpallura në ENER<sup>9</sup>

Ministria	Numri i përgjithshëm i projekt-ligjeve <sup>1</sup> (I)	Projekt-ligje me status „I hapur“ (II)	Projekt-ligje me status „I hapur“ për të cilat është përcaktuar dita e përfundimit të konsultimeve (III)	Numri mesatar i ditëve të qasjes së akteve për komente nga publiku në ENER (IV)
MF	27	26 (96%)	20	22
MBPU	22	1(5%)	0	/
ME	21	1(5%)	0	/
MPPS	17	2 (12%)	2	41
MD	15	2 (13%)	0	/
MTL	13	8 (62%)	8	62
MPB	13	9 (69%)	8	39
MK	7	2 (29%)	0	/
MShIA	6	4 (67%)	2	30
MSh	7	3 (43%)	1	19
MMJPH	4	4 (100%)	1	74
MASh	3	0 (0%)	0	/
MPJ	1	1 (100%)	0	/
MM	1	1 (100%)	0	/
MVL	0	/	0	/
<b>Gjithsej</b>	<b>157</b>	<b>64 (41%)</b>	<b>42</b>	<b>41</b>

Me qëllim që të llogaritet numri mesatar i ditëve për konsultim, janë marrë vetëm ato ligje të cilat kishin status “Të hapur” dhe të cilat në periudhën e ndjekjes janë miratuar, përkatësisht mbyllur për konsultime (shtylla III Tabela 20). Mesatarja për projekt-ligjet për të cilat është përcaktuar periudha e konsultimeve ishte 41 ditë. Periudhën më të gjatë për konsultime e kishin projekt-ligjet e MMJPH e cila ishte 74 ditë (për një projekt-ligj) dhe MTL ku afati ishte 62 ditë (për 8 projekt-ligje).



Përcaktimi i anashkalimeve të afateve kohore të nevojshme për konsultime me publikun e prekur ishin shpallur në ENER ishin analizuar dhe prezantuar në ueb-faqen [www.ogledalonavladata.mk](http://www.ogledalonavladata.mk) në pjesën „Anashkalim“ dhe e njëjta është quajtur „Anashkalim i rregullave“<sup>10</sup>.

Nga 42 projekt-ligje për të cilat është përcaktuar periudha e konsultimeve, anashkalimeve<sup>11</sup> nga afati ligjor prej 10 ditësh shfaqet tek 6 (14%) projekt-ligje të gjitha nga MF: projekt-ligji për huazim të Republikës së Maqedonisë me hua në Bankën Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim (8 ditë); projekt-ligji për mbylljen e kërkesave të Republikës së Maqedonisë në bazë të obligimeve të paguara ndaj kreditorëve të huaj dhe ndërmarrjeve të huaja të hekurudhave me shumë të vazhdueshme në HM Transport ShA Shkup (8 ditë); projekt-ligji për ndryshim të Ligjit të taksave administrative (6 ditë); Projekt-ligji për

9 Me të gjitha statutet: „I hapur“, „Në vendim“ dhe „I mbyllur“

10 <http://www.ogledalonavladata.mk/otstapki.html>

11 Si anashkalim konsiderohet periudha më e shkurtër se 10 ditë, nga dita kur projekt-ligji është vendosur në ENER deri në ditën kur ai është shqyrtuar nga Qeveria apo ka kaluar në statusin “Në vendim” apo “I mbyllur” në ENER.

ndryshim të Ligjit për tatimet e pronave (6 ditë); projekt-ligji për plotësim të Ligjit për procedurë tati-more (6 ditë); projekt-ligji për marka të avokatëve (6 ditë). Anashkalimet nga minimumi sipas Udhëzimit hasen te 24 (57%) e projekt-ligjeve që është shumë më tepër.

### 3.2.2. Praktika të komentimit në ENER

Mundësia për komentim të projekt-ligjeve në ENER ekziston pavarësisht se në cilat prej tri statuseve gjendet projekt-ligji. Ndikim real komentet e dhënë mund të kenë deri në momentin kur projekt-ligji nuk kalon në statusin “Në vendim”. Pas atij momenti, pothuajse nuk ekziston mundësi për efektim të propozimeve dhe komenteve: në 59% të rasteve publiku nuk kishte mundësi të ndikojë (edhe përkrah mundësisë për komentim). Nga ana tjetër është shqetësues fakti se ka pak komente të vendosura nga publiku. Për 157 projekt-ligjet e vendosura kishte vetëm gjashtë komente nga palët e prekura gjatë periudhës së ndjekjes së ENER. Komentet kishin të bënin me: projekt-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për energjetikën; projekt-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të shëndetësisë dhe veterinarisë; projekt-ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për shëndetin e bimëve; Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor; projekt-ligji për ndryshim të Ligjit për përcjellje të komunikimeve – version i reviduar dhe Ligjin për administratën.

Ky rezultat i komentimit minimal përkon me rezultatet e e-anketës<sup>12</sup>, ku edhe përkrah asaj se pjesa më e madhe e organizatave qytetare të anketuara janë përgjigjur se i njohin mundësitë të cilat i ofron ENER, megjithatë nuk e shfrytëzojnë që të japin mendimin e vet për projekt-ligje. Shkaqet mund të jenë të ndryshme në përputhje me qëllimet e kësaj analize nuk do të futemi në më tepër detaje.

### 3.2.3. Praktikrat për azhurnim të projekt-dispozitave të hapura në ENER

Azhurnimi i rregullt i statusit të projekt-dispozitave të hapura dhe dokumenteve që lidhen me të janë me rëndësi enorme për zmadhimin e besimit të publiku, si shembull i mirë se me përfshirje aktive me kremtim në ENER mund të ndikohet mbi proceset e përgatitjes së ligjeve. Megjithatë, rasti më i shpeshtë është projekt-ligji të mbetet me status “I hapur” edhe pas shqyrtimit të tij në Qeveri (kur duhet të kalojë në status “I mbyllur” dhe kur është miratuar në Kuvend (kur duhet të kalojë në status “I mbyllur”). Situata e tillë mund të ndikojë në kuptimin e gabuar të komentimit të projekt-ligjeve kur ato janë miratuar. Përkrah azhurnimit jo të rregullt të ndryshimeve të statusit nga personat përgjegjës për këtë në ministri, problem shtesë është edhe mangësia softuerike në ENER, përkatësisht pamundësia që të shihet se kur kanë ndodhur ndryshimet e statusit, por është në dispozicion vetëm informacioni i statusit të tashëm të dispozitës. Për nevojat e analizës është bërë ndjekje e përditshme e statuseve të dispozitave të shpallura, që të arrihet tek e dhëna se a ka kaluar projekt-ligji nga një status në tjetrin. Ndryshimet e statuseve ishin regjistruar vetëm tek 26 (17%) projekt-ligje. Vetëm në dy raste (të dy të MTL) projekt-ligji kaloi nëpër të tri statuset në ENER (nga “I hapur”, në “Në vendim” dhe në fund “I mbyllur”): projekt-ligji për ndryshim të Ligjit të Sistemit Hekurudhor dhe projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Lundrimin e Brendshëm. Për pesë projekt-ligje është regjistruar futja e tyre në procedurë qeveritare me status nga “I hapur” në “Vendim”. Në nëntë raste ligji ka kaluar nga “I hapur” direkt në “I mbyllur”.

Me këtë analizë është ndjekur edhe shpallja e dokumenteve shoqëruese të projekt-ligjeve të cilat shpallen në ENER. Domethënë, sipas Udhëzimit<sup>13</sup>, Ministrinë gjatë planifikimit dhe përpunimit të ligjeve në ueb-fqen e vet dhe në ENER i shpallin dokumentet relevante lidhur me projekt-ligje (të dhëna në Tabelën 21).

12 Emina Nuredinoska, Igor Vidaçak, Transparenca e procesit të përgatitjes së ligjeve: rregulla dhe praktika për përfshirjen e publikut në fokusin e informacionit kthyes të komenteve nga publiku, OSBE, 2012.

13 Udhëzim për mënyrën e vendosjes në punën e ministrive për përfshirjen e palëve të prekura në procedurën e përgatitjes së ligjeve, Gazeta zyrtare e RM-së, nr. 150 më 27.10.2011.



**TABELA 21. Dokumente që ishin në projekt-ligjet e shpallura në ENER**

Dokumentet	Numri i projekt-ligjeve që i përmbajnë	Përqindja e numrit të përgjithshëm të projekt-ligjeve të shpallura (159)	Përqindja e dokumenteve që ishin vendosur të zbrazët apo jopërkatës <sup>14</sup>
Lajmërimet për përpunim të ligjit	17	27%	41%
Plan për zbatim të vlerësimit të ndikimit të rregullativës	60	94%	3%
Vlerësim inicial/tërësor i ndikimit të rregullativës	58	91%	7%
Tekst i dispozitës	58	91%	0%
Shpallje për konsultime dhe mbikëqyrje publike	3	5%	0%
Raport i konsultimeve	5	8%	0%

Në Tabelën 21 është dhënë pasqyrim për sa projekt-ligje të cilat janë shpallur në ENER me status “I Hapur” janë vendosur edhe dokumente relevante për mbikëqyrje nga publiku. Nga tabela shihet se tek dokumentet kryesore të cilat duhet të vendosen kur hapet dispozita në ENER për projekt-ligjin në 94% të rasteve është shpallur plani për zbatim të PVR-së, prej të cilave 3% ishin jopërkatës<sup>15</sup> ose dokumente të zbrazura. Projekt-tekst i dispozitës ishte vendosur në 91% të rasteve dhe të gjitha ishin në rregull. PVR initiale/komplete është vendosur po në këtë përqindje, me 7% të dokumenteve të bosh/joadekuate.

Shqetëson fakti se përqindja e lajmërimeve të shpallura për përpunim të projekt-ligjeve i cili është shumë i vogël është 27%, prej të cilave 41% janë dokumente joadekuate/bosh.

Shpallja për konsultime dhe mbikëqyrje publike është vendosur vetëm në tri raste, dhe këto janë projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për mbrojtje të natyrës nga MMJPH, projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për zjarrfikës nga MM dhe projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për vendim sipas ankesave dhe propozimeve, i propozuar nga MShIA. Raport prej konsultimeve të kryera ishte vendosur vetëm në pesë, përkatësisht 8% të rasteve të analizuara. Për disa projekt-ligje të cilat janë shpallur në suazat e periudhës së ndjekjes, një pjesë e dokumenteve janë vendosur në ENER pas periudhës së ndjekjes dhe ato janë hequr nga analiza, edhe pse kjo procedurë arsyetohet vetëm tek “Raporti i konsultimeve”, i cili duhet të vendoset pas zbatimit të konsultimeve.

### 3.3. Monitorimi i ueb-faqeve të ministrive

Ministritë përveç obligimit të shpallin projekt-ligje në ENER, është e nevojshme ato t’i shpallin edhe në ueb-faqet e veta. Pjesa më e madhe e ministrive kanë një pjesë të veçantë për legjislativë<sup>16</sup> në ueb-faqet e veta ku shpallin ligje dhe projekt-ligje.

Pesë ministri (MPB, MPPS, MBPU, MK dhe MSh) në pjesën e ueb-faqes së vet dedikuar legjislativës, përveç ligjeve shpallin edhe projekt-ligje. Përkrah praktikës së tillë një pjesë e ministrive në ballinë dhe/apo në pjesën për marrëdhënie me publikun shpallin lajmërimet nëpërmjet të cilave u bëjnë thirrje palëve të prekura të përfshihen në përgatitjen e një ligji konkret, dhe këto gjashtë ministri janë: MD, MPPS, ME, MTL, MK dhe MMJPH.

60% e ministrive përdorin të paktën një mënyrë për informim dhe thirrje që publiku të përfshihet në përgatitjen e ligjeve.

<sup>14</sup> Përqindja është nxjerrë nga numri i projekt-ligjeve të cilat përmbajnë dokumente konkrete.

<sup>15</sup> Si dokumente jo përkatëse konsiderohen dokumentet e jo tërësishme, dokumentet e tjera nga i njëjti projekt-ligj apo dokumenti që nuk mund të hapet.

<sup>16</sup> hasen me emërtime të ndryshme në ueb-faqet e ministrive të ndryshme.

Shembujt dhe praktikat më të mira të cilat duhet të ndiqen japin dy ministri – MPPS dhe MK, sepse mundësojnë lajmërim në kohë për mundësinë për përfshirje në procesin e përgatitjes së ligjit, si dhe gjetjes së projekt-ligjit përkatës në pjesën për legjislativë në ueb-faqen e tyre.

### 3.4. Përfundime dhe rekomandime

157 projekt-ligje gjithsej ishin shpallur në ENER në periudhën e ndjekjes nga 1 marsi deri në 31 tetor 2012. Përfundimet dalin nga ndjekja e: ruajtjes së afateve kohore kur projekt-ligjet janë në dispozicion për mbikëqyrje nga publiku, azhurnimi i informacioneve dhe praktika e vendosjes së komenteve nga publiku dhe përdorimi i ueb-faqeve të ministrive.

#### 3.4.1. Përfundime

**1. Vetëm një pjesë e projekt-ligjeve të shpallura për mbikëqyrje publike (41%) ishin të hapura për konsultime nga publiku.** MF shfaqet si propozues i pjesës më të madhe të projekt-ligjeve me mundësi për komentim, pastaj vijojnë MJPH, MPJ, MM.

**2. Anashkalime minimale ka prej afatit ligjor të paraparë në Rregulloren e Punës së Qeverisë.** Përqindja e anashkalimeve të regjistruara nga afati ligjor prej 10 ditësh për vendosjen e projekt-ligjeve për komentim është minimal, 6 anashkalime, përkatësisht 14% e projekt-ligjeve për të cilat janë hapur dhe kanë përfunduar konsultimet. Megjithatë duhet të kihet parasysh se afati prej 10 ditësh për konsultime nuk është në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Ndjekje shtesë e anashkalimeve për periudhën prej 30 ditësh e përcaktuar me Udhëzimin është shumë më e madhe dhe shënon 57%, përkatësisht 24 anashkalime.

Numri mesatar i ditëve për mbikëqyrje publike është mbi minimumin e paraparë. Numri mesatar i ditëve është 41, që është mjaft më tepër se minimali prej 10, përkatësisht 30 ditësh për konsultime. Udhëheqës në praktikën pozitive është MMJPH me 74 ditë për një projekt-ligj të shpallur dhe MTL me 62 ditë për 8 projekt-ligje.

**3. Mosregjistrimi i statuseve nga ana e nëpunësve në ministri dhe mungesa e informacionit për datën e ndryshimit të statusit të projekt-ligjit janë një mangësi e theksuar.** Ndryshimi jo në kohë i statusit të ligjeve të shpallura (nga "I hapur", në "Në vendim" dhe në fund në "I mbyllur") dhe mangësia softuerike e ENER ndikon që palët e prekura të komentojnë ligj i cili tashmë është miratuar. Domethënë, në 59% të rasteve, sektori civil dhe palët e përgjithshme të prekura dhe opinionin nuk kanë pasur mundësi të ndikojnë, nëse merret parasysh se bëhet fjalë për një përqindje projekt-ligjesh të cilat janë shpallur pasi janë shqyrtuar nga Qeveria apo janë miratuar në Kuvend.

Vetëm në dy raste (të dy rastet e MTL) projekt-ligjet kanë kaluar nëpër të tre statutet e nevojshëm në ener (nga "I hapur", në "Në vendim" dhe në fund në "I mbyllur").

**4. ENER nuk është perceptuar si mjet për përfshirje në proceset e përgatitjes së ligjeve nga palët e prekura.** Për 157 projekt-ligje gjithsej ishte regjistruar një numër minimal komentesh, gjashtë gjithsej.

Mandej, kufizimi i numrit të fjalëve në fushën e lënies së komenteve në ENER është mangësi, kurse gjithashtu nuk ekziston ekzemplar i unifikuar për dhënie të konsultimeve publike.

**5. Shumica e ministrive (60%) i përdorin ueb-faqet e veta për informim dhe thirrje për përfshirje të publikut në proceset e përgatitjes së projekt-ligjeve të paktën në një mënyrë.** MPPS dhe





MK theksohen si shembuj pozitivë, nëpërmjet shpalljes së projekt-ligjeve në një pjesë të veçantë të legjislativës, si dhe në pjesën për lajme në ueb-faqe, duke përfshirë shumë mënyra për informim dhe komunikim me publikun. Shpallja e projekt-ligjeve në ueb-faqet nuk është interaktive de nuk nxit dialog midis palëve të prekura, kështu që përbën mangësi në përpjekjet për transparencë më të madhe dhe nxitje për përfshirje.

### 3.4.2. Rekomandime

**1. Nevojitet ruajtje e rregullave për konsultime.** Ministritë duhet t'i shpallin rregullisht të gjitha projekt-ligjet të cilat i përgatitin gjatë vitit, nga vetë fillimi, siç është paraparë në rregullativë. Projekt-ligjet të cilat i vendosin ministritë në ENER t'i shpallin në kohë për konsultime para se ato të shqyrtohen në seancën e qeverisë apo të miratohen nga Kuvendi.

**2. Praktika e shpalljes së projekt-ligjeve për konsultime me publikun në periudhë më të gjatë se minimumi ligjor duhet të mbahet edhe në të ardhmen.** Përveç asaj se praktika dëshmon se ministritë i përmbahen afatit ligjor prej 10 ditësh për vendosje të projekt-ligjeve në konsultim në ENER. megjithatë përpjekjet në të ardhmen duhet të drejtohen kah **zmadhimin të tij për përputhje** me afatin prej 30 ditësh. Njëkohësisht propozohet edhe ndryshim i Rregullores së punës së qeverisë ku afati prej 10 ditësh do të harmonizohet me udhëzimin dhe zmadhohet në 30 ditë minimum.

**3. Ministritë rregullisht t'i regjistrojnë të gjitha ndryshimet të cilat ndodhin në statusin e projekt-ligjit.** Pas shpalljes së projekt-ligjeve është e domosdoshme ministritë të jenë azhurne në regjistrimin e ndryshimeve (në status, në dokumente etj.) që të parandalohet konfuzioni tek publiku për fazat e përgatitjes ku gjendet një projekt-dispozitë e caktuar dhe në këtë mënyrë të mos vendoset nën pikëpyetje mundësia e tyre për përfshirje cilësore. Në mënyrë softuerike të mundësohet regjistrim i datës së ndryshimeve të statuseve dhe historia e ndryshimit të statuseve.

**4. Nevojiten aktivitete të vazhdueshme për përmirësim dhe promovim të ENER.** Me qëllim që të nxitet komentimi thelbësor dhe kontributi i palëve të prekura, nevojiten ndryshime në ENER, jo vetëm në afate dhe publiku për periudhën e konsultimeve. por është e nevojshme edhe vendosja e dokumenteve/ekzemplarëve të unifikuar të cilat do të përdoren nga palët e prekura kur komentojnë një projekt-ligj të caktuar. Gjithashtu, dhënia e informacioneve kthyesë për komentet e dhëna do të ndikojë në zmadhimin e besimit, kurse kështu do të zmadhohet edhe cilësia e të gjithë procesit konsultues. Palët e prekura, duhet në **mënyrë aktive dhe thelbësore të përfshihen** dhe të japin mendimet e tyre dhe komentet në ENER. Njëkohësisht të veprojnë së bashku dhe rrjetë dhe të qarkullojnë informacione, duke këmbëngulur dhe duke kryer trysni që të ketë transparencë në ministri.

Në drejtim të plotësimin të pjesës së dytë për të dhënat e hapura nga plani aksionar për iniciativ të cilave u bashkëngjitet edhe Qeveria e RM-së për "Partneritet i hapur qeveritar" dhe ngjithja më lartë në pemë për të dhëna të hapura, ENER duhet të hapë, **të dhënat e ministrive** dhe të shfrytëzojë **formatet e hapura të dokumenteve**, në vend të ekzistueseve. çka do të kontribuojë për komentim të lehtë dhe përdorim më të madh dhe mundësi për përpunim të të dhënave.

**5. Përdorimi i të gjitha mënyrave në dispozicion të ueb-faqeve të ministrive për informim të publikut dhe përgatitje të projekt-ligjeve.** Ministritë duhet t'i marrin parasysh shembujt pozitivë të ueb-faqeve të MPPS-së dhe MK-së dhe procedurën për shpalljen e projekt-ligjeve ta përsëritin për të gjitha ligjet të cilat janë propozim i tyre. Në këtë mënyrë do të sigurojnë publik të informuar në kohë dhe që do të përfshihet në proceset e përgatitjes së ligjeve. Në të ardhmen nevojitet zmadhim i interaktivitetit, d.m.th. mundësim i palëve të prekura ta shprehin mendimin e vet dhe të japin koment për një projekt-ligj të caktuar në ueb-faqe.

## SHTOJCA 1: MBËSHKETJA KOMUNIKUESE

### Mekanizmat e përgjithshëm për përfshirjen e publikut

#### Ministria:

1.	Ka caktuar person përgjegjës për kontakt për dhënien e informatave me karakter publik	po	jo
2.	Ka caktuar koordinator i cili bën vlerësimin e ndikimit të rregullativës	po	jo
3.	Boton publikime (buletinë/revista) për punën e vet	po	jo
4.	Çdo herë publikon informatë në fillim për përgatitjen e ligjeve në gazetën ditore	po	jo
5.	Shpall informata për fillimin e procedurës për ligjin në ueb faqe relevante, si p.sh. ENER, e-demokratija, ueb faqja e ministrisë Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
6.	Përdor forma tjera për informim të opinionit Nëse përgjigjja është Po, cekni cilat:	po	jo

#### Ministria në ueb faqen e vet pse e-buletinin:

1.	Shpall hollësi dhe informata për përfshirjen e publikut në procese konkrete (ligje, strategji etj.) Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
2.	Përdor e-pyetësorë për marrjen e mendimit nga publiku Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
3.	Shpall propozime dhe komente të marra nga publiku i interesuar lidhur me punën e ministrisë Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
4.	Përdor e-pyetësorë për marrjen e mendimit nga publiku, i përgatitur enkas për procese konkrete Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
5.	Shpall përgjigje dhe sqarime për propozimet dhe komentet e dhëna nga publiku i interesuar Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
6.	I shpallën pyetjet më shpesh të parashtruara dhe përgjigjet për përfshirjen e publikut në procese të caktuara konkrete Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
7.	Mundëson që publiku i interesuar të regjistrohet në regjistër për marrjen e informatave Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes::	po	jo
8.	Dërgon e-mail me informata deri te publiku i interesuar Organizon e-debate publike (forum, bllok, ueb-konferencë etj.), për të cilat përgatit dhe shpall raport Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo

### Ambienti mbështetës për përfshirjen e sektorit civil

#### Ministria:

1.	ka emëruar person për bashkëpunim me organizatat qytetare	po	jo
2.	Ka regjistër, ku në mënyrë të hapur mund të regjistrohen organizatat qytetare (për marrjen e rregullt të informatave) Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
3.	I fton organizatat qytetare të interesuara që të paraqiten/regjistrohen për marrjen e informatave	po	jo
4.	Ka dokument të veçantë të shkruar (udhëzime) për përfshirjen e organizatave qytetare	po	jo
5.	I inkuadron përfaqësuesit e organizatave qytetare në trupat këshillëdhënëse dhe komisionet e ministrive, dhe kur kjo nuk është e domosdoshme	po	jo



6. I inkuadron përfaqësuesit e shoqërisë civile në delegacionet veta në evenimente ndërkombëtare	po	jo
7. Ka procedurë paraprakisht të paraparë për zgjedhjen e përfaqësuesve të organizatave qytetare kur numri për pjesëmarrje është i kufizuar	po	jo
8. Ka nëpunës shtetëror të cilët janë edukuar enkas (kanë marrë pjesë në trajnime) për bashkëpunim dhe përfshirje të organizatave qytetare	po	jo

### Ambienti financiar për përfshirje të sektorit civil

#### Ministria:

1. Financon programe (mbështetje financiare) të organizatave qytetare	po	jo
2. Financon projekte (aktivitete projekti) të organizatave qytetare	po	jo
3. Ka mjete për mbulimin e shpenzimeve për pjesëmarrësit e sektorit civil në trupat dhe grupet punuese dhe këshillëdhënëse	po	jo
4. Ka paraparë mjete për mbështetje profesionale për pjesëmarrjen (si p.sh. konsultime juridike dhe mbështetje informatike) dhe avokim të organizatave qytetare	po	jo
5. Organizatave qytetare u siguron zyra të subvencionuara ose falas	po	jo
6. Mundëson forma tjera të mbështetjes (si dhënia e pajisjes, trajnimeve etj.).	po	jo

### Përcjellja dhe vlerësimi i zbatimit të akteve

#### Ministria:

1. E përcjell dhe e vlerëson zbatimin e akteve në fushën e vet	po	jo
2. I inkuadron përfaqësuesit e organizatave qytetare në përcjelljen dhe vlerësimin e akteve	po	jo
3. Publikon raporte nga përcjellja dhe vlerësimi i akteve dhe atë: - Formati elektronik (Adresa (URL) e ueb faqes - _____) - Formati i shtypur (p.sh. publikime etj.)	po	jo
4. Shpall raport kthyes (fid bek) për përfshirjen e publikut dhe ndikimin e komenteve Nëse përgjigjja është PO, cekni adresën (URL) të ueb faqes:	po	jo
5. Në fund të përgatitjes së akteve në memorandum çdo herë informon për përfshirjen dhe bashkëpunimin me publikun e interesuar	po	jo

### A keni komente ose pyetje lidhur me pyetësoarin?

#### Pyetjeve iu përgjigj (emri dhe mbiemri):

#### Ministria:

#### Funksioni:

#### Vendi dhe data:

## SHTOJCA 2. PYETËSOR PËR PËRFSHIRJEN E PUBLIKUT NË PROCESIN E PËRGATITJES SË PROPOZIM-LIGJEVE

### Ndarja e informatave për procesin e përgatitjes së propozim-ligjeve

#### Ministria e ka lajmëruar opinionin për fillimin e procedurës për përgatitjen e propozim-ligjit:

1. Publikohet në planin strategjik dhe programin vjetor për punë të Qeverisë	po	jo
2. Me publikimin e informatës në ueb faqen e ministrisë	po	jo
3. Me informatë të dërguar deri te të gjitha palët e interesuara (p.sh. posta e drejtpërdrejtë, posta elektronike)	po	jo
4. Me informatë për fillimin e procedurës të publikuar në portal publik: e-demokratija ose ENER	po	jo
5. Me publikimin e informatës në gazetat ditore	po	jo
6. me lloje tjera të informimit	po	jo

Nëse po, me cilat

#### Informata për fillimin e procedurës për përgatitjen e propozim-ligjit përmban:

7. Emri i propozim-ligjit	po	jo
8. Synimi dhe qëllimet e procedurës	po	jo
9. Korniza kohore e ngjarjeve më të rëndësishme: identifikimi i fazave më të rëndësishme në procedurë	po	jo
10. Metodatat dhe veglat e parapara për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e publikut	po	jo
11. Identifikimi i palëve kyçe të prekura	po	jo
12. Në rast të ekzistimit të studimeve për temën e propozim-ligjit, të njëjtat a janë konsultuar dhe a ka informatë për publikun se ku mund t'i gjejë	po	jo
13. A ka dhe ku janë të kapshme informatat përmbledhëse nga studimet të cilat do ishin me dobi për publikun (nga aspekti laik)	po	jo
14. Afatet e parapara për miratimin e propozim-ligjeve	po	jo
15. Thirrje për inkuadrimitin e publikut	po	jo



16. Shpenzimet e parapara për procesin e përgatitjes së propozim—ligjit	po	jo
17. Të dhëna për kontaktin (persona përgjegjës për përgatitjen e propozim-ligjit etj.)	po	jo
18. Metoda për grumbullimin dhe marrjen parasysh të mendimeve të publikut	po	jo
19. Përcjellja dhe vlerësimi i procesit	po	jo

#### Tekste profesionale për përgatitjen e propozim-ligjeve (studim, analizë, pasqyrë etj.):

20. Janë të kapshme në ueb faqet e ministrisë	po	jo
21. Janë të kapshme në formë të shtypur (në letër) në ministri	po	jo
22. Përmbajnë pjesë përmbledhëse për publikun e përgjithshëm (jo profesionale)	po	jo
23. Ministria ka porositur tekste profesionale:	po	jo
- Nga organizata qytetare	po	jo
- Nga subjekte tjera të kontraktuara (firma konsultuese, ekspertë, universitete)	po	jo

#### Korniza kohore

24. Për shkak të konsultimit propozim-ligji shpallet si:		
Version i parë pune i propozim ligjit i dalë nga Ministria	po	jo
Propozim-ligj pas harmonizimit ndër-sektorial	po	jo
25. Afatet për pranimin e propozimeve me shkrim dhe komentet për propozim-ligjin nga ana e sektorit civil kanë qenë:		
- Më gjatë se 30 ditë pune		
- Prej 15 deri 30 ditë pune		
- Prej 10 deri 15 ditë		
- Më pak se 10 ditë		
- Nuk kishte mundësi për propozime dhe komente		
26. Nëse keni organizuar ngjarje për konsultime (fizike ose në ueb faqe) gjatë përgatitjes së propozim-ligjit, kur e dërguar ftesën për pjesëmarrje në konsultime?		
- Më shumë se 15 ditë para ngjarjes		
- Prej 7 deri 15 ditë		
- Më pak se 7 ditë		
- Nuk organizuam ngjarje të tillë		
27. Kur caktohet afati për konsultime a keni mbajtur llogari për festat dhe datat tjera të rëndësishme në atë periudhë?	po	jo

**Zbatimi i procedurës së përgatitjes së propozim-ligjit**

<b>Ministria:</b>		
28. Emëron person i cili jep informata për përgatitjen e propozim-ligjit dhe për inkuadrimin e publikut në procedurë	po	jo
29. Mundëson inkuadrimin e sektorit civil në fazën e hershme kur formulohen tezat/parimet e propozim-ligjit	po	jo
30. Në procesin e përgatitjes së propozim-ligjit organizon ngjarje për inkuadrimin e publikut si diskutime publike, tryeza të rrumbullta etj.	po	jo
31. Mundëson udhëheqje të pavarur të ngjarjeve për inkuadrimin e publikut në procesin e përgatitjes së propozim-ligjit (p.sh. facilitues nga ndonjë institucion tjetër, ekspert i jashtëm etj.)	po	jo
32. Në fazën e hershme, publikut i prezantohen zgjidhjet e ndryshme për propozim përmbajtjen e propozim ligjit	po	jo

**Përgjigja e ministrisë ndaj propozimeve të sektorit civil**

33. Ministria për propozimet e arritura nga sektori civil:		
- Nuk e jep mendimin e vet	po	jo
- E jep mendimin e vet si informatë të përbashkët	po	jo
- E jep mendimin e vet për çdo propozim veçmas	po	jo
34. Ministria deri te sektori civil përgatitën raport kthyes (fidbek)	po	jo
35. Ministria në ueb faqen e vet i publikon komentet, propozimet dhe argumentimin e dhënë nga sektori civil	po	jo
36. Ministria publikon informatë të shtypur për komentet, propozimet dhe argumentet e sektorit civil për propozim ligjin	po	jo
37. Në memorandumun e propozim-ligjit ka informata për publikun e përfshirë në procesin konsultativ	po	jo



### Përgjigja e sektorit civil

38. Ministria në përgatitjen e propozim-ligjit përfundimtar i inkuadron edhe komentet e sektorit civil

po	jo
----	----

- Ministria nuk i inkuadron propozimet e sektorit civil pasi që:

\_\_\_\_\_

- Ministria në pjesën më të madhe i inkuadron propozimet pasi që

\_\_\_\_\_

39. Cilat janë vlerësimet e propozimeve dhe komenteve të sektorit civil, sipas pikëpamjes së ministrisë:

- Në pjesën më të madhe janë relevante lidhur me përmbajtjen dhe ekspertizën

po	jo
----	----

- Pjesërisht janë relevante, ndërsa pjesërisht nuk janë relevante

po	jo
----	----

- Pothuaj të gjitha janë relevante

po	jo
----	----

- Nuk morëm komente dhe propozime nga sektori civil

po	jo
----	----

40. Ministria gjatë përgatitjes së propozim-ligjit

- Është e kënaqur me jehonën e publikut

po	jo
----	----

- Nevojitet jehonë më e madhe nga publiku

po	jo
----	----

- Nuk ka mendim për bashkëpunimin me publikun

po	jo
----	----

### Cilat organizata i kanë komentuar propozim-ligjet?

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### Komente tjera për inkuadrin e sektorit civile në procesin e përgatitjes së ligjit:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### Komentet tuaja lidhur me çështje të caktuar/a ose pyetësorin në përgjithësi:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

### SHTOJCA 3. LISAT E PROJEKT-LIGJEVE TË PËRFSHIRA NË ANALIZË SIPAS MINISTRIVE

	Ministria kompetente	Dispozita e pritur	Përgjigjja e marrë
1	Ministria e Punëve të Brendshme	Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për armët	Po
2		Ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për siguri të komunikacionit dhe rrugëve	Po
3		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përcjellje të komunikimeve	Po
4	Ministria e Ekonomisë	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për standardizim	Po
5		Projekt-ligji për tregti në tregjet e gjelbra	Po
6		Projekt-ligji për nxitje të hulumtimit, zhvillimit dhe inovacioneve tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë	Jo
7	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Menaxhim me mbeturinat	Po
8		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për ujërat	Po
9	Ministria e Shëndetësisë	Projekt-ligji për mbrojtje shëndetësore	Po
10		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për sigurim shëndetësor	Jo
11	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Ujërave	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për cilësi të prodhimeve bujqësore	Po
12		Projekt-ligji për identifikim dhe regjistrim të kafshëve	Jo
13	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës	Projekt-ligji për material të arkivit	Po
14		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për komunikime elektronike	Po





15	Ministri e Kulturës	Projekt-ligji për shpallje të monumentit përkujtimor të Krushevës për trashëgimi kulturore me rëndësi të veçantë	Po
16	Ministria e Punëve të Jashtme	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për punët e jashtme	Po
17	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Projekt-ligji për Ndryshim dhe plotësim të Ligjit të arsimit të mesëm	Po
18		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të arsimit tetëvjeçar	Po
19		Projekt-ligji për standard studentor	Po
20	Ministria e Drejtësisë	Projekt-ligji për pronë të konfiskuar, dobi prone dhe objekte të marra në procedurë penale dhe kundërvajtje	Jo
21		Projekt-ligj për të drejtat e fëmijëve	Jo
22		Ligji për shërbim publik të prokurorisë	Jo
23	Ministria e Transportit dhe Lidhjeve	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për pastërti publike	Jo
24		Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për aviacion	Jo
25		Projekt-ligj për veprimtari komunale	Jo
26	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale	Projekt-ligj për ndryshim të Ligjit për familje	Po
27		Projekt-ligji për ndryshim të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve	Po
28		Projekt-ligj për ndalim të vlefshmërisë së Ligjit për të drejtat e anëtarëve të familjeve, kryefamiljari i të cilit është ushtarak në shërbim ushtarak	Po
29		Projekt-ligji për sigurim pensional dhe invalidor	Po
30	Ministria e Financave	Projekt-ligji për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese	Jo
31		Projekt-ligji për plotësim të Ligjit për procedurë tatimore	Jo
32		Projekt-ligji për pullat e avokatëve	Jo
33		Projekt-ligji për kryerjen e punëve të kontabilitetit	Jo